

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6121  
E mërkurë, 23 shtator 2020  
çmimi 0.40 €

Si po krijohen  
problemet kombëtare  
dhe shoqërore FAQE 7

Nga Jakup  
KRASNIQI



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI DHE MINISTRI I SHËNDETËSISË, ARMEND ZEMAJ, KANË  
VIZITUAR SHËRBBIMIN SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS (SHSKUK) FAQE 4-5

## KRYEMINISTRI THOTË SE MASAT ANTI COVID DO TË MBESIN NË FUQI



Përfaqësuesit institucionalë dhe ekspertët shëndetësorë kanë bërë me dije se Kosova tanimë e ka nën kontroll menaxhimin e pandemisë. Gjatë vizitës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës

(ShSKUK), kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se Kosova është në rrugën e duhur të menaxhimit të pandemisë. Ai ka treguar se për shkak të frikës nga vala e dytë e Covid-19 në vjeshtë, qeveria nuk

pritet t'i lehtësojë masat anti Covid. Ndërsa Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t'i lehtësojnë këto masa

### AKTUALE



NASA SHPALOS PLANIN  
PËR RIKTHIMIN NË HËNË  
NË VITIN 2024 F. 2

HOTI FTOHET TË RAPORTOJË NË  
KOMISIONIN PËR LEGJISLACION  
PËR ASOCIACIONIN F. 6

### EKONOMI

SEKTORI I HOTELERISË  
PRANË KOLAPSIT,  
17 000 PERSONA RREZIKOJNË  
TË MBESIN PA PUNË F. 8

MINISTRI KRASNIQI SHEH NGA  
AFËR NDARJEN E PRODUKTEVE  
BIMORE DHE SHTAZORE F. 8



### SPORT

ARBËRIA NDALI PRISHTINËN,  
DRENICA MPOSHTI BEŠËN F. 14



## ZGJEDHJET LOKALE 2021, RREZIK TË MOS MBAHEN, SHKAK BUXHETI I SHKURTUAR

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) qysh tani ka filluar të organizohet për zgjedhjet lokale të cilat planifikohen të mbahen vitin e ardhshëm. Ky institucion ka paraqitur në Ministrinë e Financave planifikimin buxhetor për

organizimin e këtyre zgjedhjeve, i cili, siç merret vesh, është mbi 7 milionë euro. Në kuadër të këtij buxheti planifikohet edhe raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarët e komunave. Por, në këtë institucion kanë ngritur shqetësimin

për mundësinë që ky buxhet të mos miratohet sipas kërkesës së KQZ-së, ngaqë MF-ja ka ofruar 2 milionë euro më pak. Anëtarë i KQZ-së, Sami Hamiti, ka thënë se kjo mund ta rrezikojë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve FAQE 3

## 22 VJET NGA RËNIA E HERONJVE FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, PËRKUJTOHET LUFTA DHE SAKRIFICA E TYRE FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## 90 balena ngordhin në brigjet e Australisë

CANBERRA, 22 SHTATOR - Ekipet e shpëtimit kanë bërë përpjekje të martën që të shpëtojnë qindra balena, të cilat kanë ngecur në rërën e brigjeve të ishullit australian, Tasmania, ndërkohë që dhjetëra gjitarë të tjerë ujorë kanë ngordhur.

Biologët e marinës kanë vlerësuar se rreth 90 prej 270 balenave, kanë ngordhur në ujërat e cekët, prej kur është raportuar

bllokimi i tyre një ditë më parë. Operacioni i shpëtimit pritet të marrë disa ditë.

Përmes disa fotografive është parë një numër i madh i balenave në Portin Macquarie, rreth 200 kilometra në veriperëndim të kryeqytetit shtetëror, Hobart. Balenat e bllokuara janë një lloj i delfinit oqeanik, që rriten deri në shtatë metra gjatësi dhe mund të peshojnë deri në tre tonë.

Rreth 40 shkencëtarë qeveritarë, 20 zyrtarë policorë, peshkatarë dhe vullnetarë të tjerë janë përfshirë në operacionin e shpëtimit. Shkencëtarët nuk e dinë se çfarë nxititi tërheqjen e balenave në breg.

Daljet e balenave në brigje përbëjnë gjë të zakonshme në këtë rajon, ndonëse diçka e tillë, si më 21 shtator, nuk është parë nga viti 2009.



## NASA shpalos planin për rikthimin në Hënë në vitin 2024

WASHINGTON, 22 SHTATOR - Agjencia Amerikane e Hapësirës (NASA) shpalosi zyrtarisht planin e saj për t'u kthyer në Hënë në vitin 2024. Në kuadër të programit të quajtur Artemis, i cili do të kushtojë rreth 28 miliardë dollarë, NASA do të dërgojë në sipërfaqen hënore një burrë dhe një grua. Do të jetë ky aterrimi i parë i njerëzve atje qysh në vitin 1972. Megjithatë, afati kohor i agjencisë do të varet edhe nga Kongresi Amerikan që pritet të lëshojë rreth 3.2 miliardë dollarë për

ndërtimin e një sistemi të zbarkimit.

Astronautët do të udhëtojnë me një kapsulë të ngjashme me Apollon e vitit 1972, por që quhet Orion dhe që do të nisët nga një raketë e fuqishme e quajtur SLS. "Shuma prej 28 miliardë dollarësh përfaqëson kostot e katër vjetëve të ardhshëm në programin Artemis: financimin e SLS-së, financimin e Orionit, sistemin e aterrimin të njerëzve dhe natyrisht kostumet hapësinore", tha administratori i NASA-s, Jim Bridenstine. "Kërkesa për

buxhet që kemi përpara Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit të ShBA-së tani është 3.2 miliardë dollarë për vitin 2021. Është shumë e rëndësishme që t'i sigurojmë ato 3.2 miliardë dollarë", ka thënë Bridenstine. Ai, po ashtu, ka thënë se shpreson se ekipi që do të shkojë në Hënë, do të zgjidhet së paku dy vjet përpara misionit. Programi Artemis do të jetë misioni i parë që dërgon astronautë në sipërfaqen hënore qëkur Apollo 17 e ka bërë një gjë të tillë, rreth 48 vjet më parë.



## Italianët votojnë për zvogëlim të numrit të ligjvënësve në parlament



ROMË, 22 SHTATOR - Italia ka votuar për ta ulur numrin e deputetëve në parlament për më shumë se një të tretën. Pothuajse 70 për qind e njerëzve kanë votuar në të mirë të ndryshimeve, pas gati të gjitha votave të numëruara.

Numri i ligjvënësve në Dhomën e Ulët të Parlamentit të Italisë do të ulet nga 634 në 400. Senati, po ashtu, do të zvogëlohet. Në total

numri i deputetëve dhe senatorëve do të ulet nga 945 në 600. Ky referendum është çuar përpara nga Lëvizja Pesë Yjet, pjesë e koalicionit qeverisës, e cila ka thënë se një hap i tillë do t'i ulë shpenzimet.

Votimet janë zhvilluar bashkë me disa zgjedhje rajonale, rezultatet e të cilave kanë shënuar kthim mbrapa në mbështetje për liderin e partisë

Liga, Matteo Salvini dhe rritje të përkrahjes për të majtët e qendrës, të cilët janë pjesë e koalicionit qeverisës të kryeministrit, Giuseppe Conte. Ky ndryshim veçse është miratuar në parlament, mirëpo për finalizim është nevojitur referendum, meqë duhet bërë ndryshime kushtetuese. Ndryshimet tani duhet të bëhen para zgjedhjeve të vitit 2023.

## Gjiganti "Airbus" sjell avionët me zero emetime

PARIS, 22 SHTATOR - Gjiganti i fluturimeve "Airbus" ka zbuluar planet për atë që konsiderohet avioni i parë komercial me zero emetime. Kompania ka njoftuar se avionët e pasagjerëve që do të operojnë tërësisht me hidrogjen mund të jenë në shërbim deri në 2035-n.

Shefi ekzekutiv i "Airbus", Guillaume Faury, ka thënë se avionët me zero emetime përbëjnë një moment historik për sektorin e aviacionit komercial. "Përdorimi i hidrogjenit ka potencialin për

të reduktuar në mënyrë domethënëse pasojat te klima", ka thënë ai. Sidoqoftë, analistët tregojnë se kjo nuk është hera e parë që hidrogjeni është parë si shpëtimtari i udhëtimeve moderne ajrore.

Që në vitet 2000-2002 "Airbus" u përfshi në një projekt të financuar nga BE-ja që studionte fisibilitetin e një avioni që punon me hidrogjen të lëngshëm. Por, ideja, deri më tani, u la në haresë. Duke zbuluar projektet e tij më të fundit, "Airbusi" prezanton tri modelet e të ardhmes,

"Turbofan" që mund të mbajë deri në 200 pasagjerë, "Turboprop" me kapacitet 50 për qind më të vogël dhe projektin e tretë, që ishte edhe më goditësi.

Të tre avionët do të marrin fuqi nga motorë me turbina gazi të modifikuara për ta djegur hidrogjen të lëngshëm, madje edhe energjia elektrike do të prodhohet nga hidrogjeni. Sidoqoftë, "Airbus" pranon se të funksionojë ideja, aeroportet duhet të investojnë shuma të mëdha parash për infrastrukturën.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kërkon 7 milionë euro për zgjedhjet lokale të 2021-s

## Zgjedhjet lokale 2021, rrezik të mos mbahen, shkak buxheti i shkurtuar

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) qysh tani ka filluar të organizohet për zgjedhjet lokale të cilat planifikohen të mbahen vitin e ardhshëm. Ky institucion ka paraqitur në Ministrinë e Financave planifikimin buxhetor për organizimin e këtyre zgjedhjeve, i cili, siç merret vesh, është mbi 7 milionë euro. Në kuadër të këtij buxheti planifikohet edhe raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarët e komunave. Por, në këtë institucion kanë ngritur shqetësimin për mundësinë që ky buxhet të mos miratohet sipas kërkesës së KQZ-së ngaqë MF-ja ka ofruar dy milionë euro më pak. Anëtari i KQZ-së, Sami Hamiti, ka thënë se kjo mund ta rrezikojë mbajtjen e këtyre zgjedhjeve



**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Zgjedhjet e parapara lokale për vitin e ardhshëm rrezikojnë të mos mbahen për shkak të shkurtimeve buxhetore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka paraqitur në Ministrinë e Financave planifikimin buxhetor për organizimin e këtyre zgjedhjeve, e që është mbi 7 milionë euro. Ndërsa ky institucion ka ofruar shumën për rreth 3 milionë euro më pak. Kështu u tha në mbledhjen e së martës të KQZ-së, ku anëtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK),

Sami Hamiti, ka thënë se projeksi buxhetor i zvogëluar rrezikon mbajtjen e zgjedhjeve lokale të parapara për 2021. “Është shqetësues projeksi i buxhetit për vitin 2021. Është zvogëluar nën masën, prandaj rrezikohet mbajtja e zgjedhjeve. Në projeksionin e pjesës të kodit për zgjedhje është marrë shuma me një krahasim me zgjedhjet nacionale, e dihet që zgjedhjet nacionale janë më të ulëta. Total projeksi ka rënë për 3 milionë euro. Unë shoh që duhet të bëjmë arsyetime të plota, sepse në buxhet rrezikohet mbajtja e zgjedhjeve dhe nuk ka mundësi për mbajtjen e tyre”, ka thënë

Hamiti. Ndërkohë që KQZ-ja ka planifikuar buxhet mbi 7 milionë euro për zgjedhjet lokale 2021, për të dyja raundet, ndërsa Ministria e Financave ka planifikuar mbi pesë milionë. Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, ka thënë se do t'i drejtohen qeverisë sa i përket shkurtimit të buxhetit. “Me siguri qeverisë do t'i drejtohem me një shkresë, do të kërkojmë një lloj shpjegimi nëse është gabim apo ky shkurtim është bërë qëllimisht”,

ka thënë Daka. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar edhe raportin e auditorit të brendshëm. Sylejman Gashi nga Auditori i Brendshëm ka theksuar se në bazë të këtij raporti nga viti 2014, 2017 e 2019, ka pasur rritje të stafit jopermanent, ku edhe janë keqpërdorur rreth 160 mijë euro. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar edhe raportin e auditorit të brendshëm. Sylejman Gashi nga Auditori i Brendshëm tha se, në bazë të këtij raporti nga viti

2014, 2017 e 2019, ka pasur rritje të stafit jopermanent, ku edhe janë keqpërdorur rreth 160 mijë euro. “159 mijë euro është shuma e shpenzuar nga stafi jopermanent pa autorizim të KQZ-së. Për këtë çështje duhet një aprovim, edhe një arsye e madhe, sepse po vazhdohet angazhimi i tyre, pastaj edhe një autorizim i KQZ-së. Kjo shumë e mjeteve është pa lejen e zotit të shtëpisë. Pjesa e dytë ka të bëjë me pasojat financiare të rinumërimit të fletëvotime”, u shpreh ai.

## Hoti ftohet të raportojë në Komisionin për Legjislacionin për Asociacionin

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, do të raportojë në Komisionin për Legjislacionin për zotimin e tij për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe si dhe procesin e Vetëvendosjes. Inicuesi i kësaj kërkesë, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Artan Abrashi, ka thënë se kryeministri duhet të sqarojë si do ta themelojë “Zajednicën”. “Është shumë e rëndësishme që kryeministri të vijë dhe të raportojë për deklaratat publike për themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe në Kosovë. Ta kemi këtu për ta pyetur se si e ka menduar implementimin e këtij asociacioni. Ky raportim nuk ka të bëjë me raportimin e Hotit në Kuvend”, ka thënë ai. Për këtë çështje u pajtua edhe deputeti i PDK-së, Abelard



Tahiri, i cili tha se duhet të sqarohen këto zotime, si dhe kërkoi që kryeministri të raportojë edhe për vetëvendosjen. Por këtë kërkesë e cilësoi si të

pabazuar kryetari i komisionit, Shkëmb Manaj. Ndërkaq, komisioni nuk arriti të kalojë në parim Projektin Kodin Civil për shkak të

vërejtjes së deputetëve opozitarë të Lëvizjes Vetëvendosje. Komisioni diskutoi edhe për Projektligjin për Tokën Ndërtimore i cili nuk

kalo për shkak të vërejtjeve të deputetëve. Për këtë u kërkua raportimi i ministrit të Drejtësisë, Selim Selimi, për këtë çështje.



KRYEMINISTRI AVDULLAH HOTI DHE MINISTRI I SHËNDETËSISË, ARMEND ZEMAJ, KANË VIZITUAR SHËRBIMIN SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS (SHSKUK)

# KRYEMINISTRI THOTË SE MASAT ANTI COVID DO TË MBESIN NË FUQI

Përfaqësuesit institucionalë dhe ekspertët shëndetësorë kanë bërë me dije se Kosova tanimë e ka nën kontroll menaxhimin e pandemisë. Gjatë vizitës në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se Kosova është në rrugën e duhur të menaxhimit të pandemisë. Ai ka treguar se për shkak të frikës nga vala e dytë e Covid-19 në vjeshtë, qeveria nuk pritet t'i lehtësojë masat anti Covid. Ndërsa Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t'i lehtësojnë këto masa

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHINË, 22 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se është rritur vetëdija qytetare për rrezikun nga Covid-19. Gjatë vizitës që i ka bërë Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), ai ka vlerësuar se Kosova është në rrugën e duhur për menaxhimin e pandemisë. Hoti ka thënë se duhen shtërënguar masat në mënyrë që të përgatiten për vjeshtë. "Rënia e rasteve na ka dhënë një qetësi shpirtërore. Ju përgëzoj për punën. Po hyjmë në fazën e vjeshtës. Besoj se jemi në rrugë të duhur për menaxhimin e pandemisë. Objekti duhet të bëhet gati për vjeshtë, të nisë vaksinimi i rregullt që të kemi një mbrojtje për grupet e rrezikuara. Para dy muajve 30 deri 40 për qind

nuk besonin se virusi ekziston, por tash kemi një situatë tjetër. Në kuadër të një plani të investimeve e kemi futur edhe shëndetësinë, i kemi marrë disa inpute për të krijuar një buxhet që t'i rrisim kapacitetet shëndetësore", ka thënë ai.

Kryeministri Hoti ka treguar se qeveria nuk e ka në plan ta bëjë lehtësimin e masave. "Ministri ka presione të ndryshme nga grupe, por duhet t'i mbajmë këto pasi vala e dytë është kthyer në Evropë, andaj duhet të jemi të përgatitur. Do të vazhdojmë t'i kryejmë pagesat për shtesën që do të paguhet të gjithë nga personeli", ka deklaruar Hoti. Ai ka thënë se është me rëndësi për të hyrë në plane afatgjata të ristrukturimit komplet të institucioneve shëndetësore dhe në këtë mënyrë të riorganizohet komplet sistemi shëndetësor për t'u përballur me

këtë pandemi dhe me pandemitë që mund të paraqiten në vitet që vijnë. "Kemi korrur rezultate të jashtëzakonshme, t'i mbajmë këto rezultate dhe në këtë mënyrë të jemi të përgatitur për zhvillimet që mund të ndodhin", ka thënë Hoti, duke shprehur ngushëllime për të gjitha familjet, pjesëtarët e të cilëve kanë humbur jetën dhe u ka uruar shërim të shpejtë atyre që janë duke u trajtuar.

Kryeministri Hoti ka premtuar se derisa të bëhet Ligji i Pagave do të vazhdohet në bazë të vendimit të qeverisë për një shtesë, që nuk është e mjaftueshme, por tregon përkushtimin e shoqërisë dhe shtetit për punën që po bëjnë mjekët dhe personeli ndihmës dhe të gjithë ata që janë në zinxhirin e shërbimeve shëndetësore.

Kurse ministri i Shëndetësisë, Armend Zema, ka kërkuar që

kujdesi i të gjithëve të jetë plotësisht në shërbim të të gjithë qytetarëve, 24 orë në ditë, shtatë ditë të javës. "Ne në vazhdimësi po përpiqemi për fuqizimin e kuadrove mjekësore, furnizimeve, përmirësimin e infrastrukturës në spitale. Kërkoj përkushtimin e plotë të secilit pjesëtar dhe secilës hallkë të sistemit, për efikasitet dhe efikasitet maksimal, ndërsa si Ministri e Shëndetësisë po ndërmarrim të gjitha veprimet që të jemi të gatshëm në rast se virusi do të vazhdojë të jetë pranishëm edhe nëpërgjatë muajve të stinës së vjeshtës", ka thënë Zema.

Ai ka theksuar se angazhimi i personelit shëndetësor dhe stafit përcjellës, ishte, është dhe mbetet shembullor si përgjegjësi profesionale dhe morale e atdhetare, për të qenë në shërbim të qytetarëve. "Andaj sot e çdo ditë jemi shumë mirënjohës dhe i falënderojmë pafundësisht për punën e tyre të palodhur. Gjithnjë do të qëndrojmë në krah të tyre dhe do t'u ofrojmë përkrahje të rezervë aty ku e kanë të nevojshme. Puna jonë nuk do të ndalet. Po ashtu për ne është jetike edhe kontributi dhe ndihma e ofruar nga donatorët ndërkombëtarë", ka deklaruar Zema.

Ndërkaq ushtruesi i detyrës i drejtorit të Shërbimit Spitalor dhe

Klinik Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka deklaruar se prania e kryeministrit Hoti është një vlerësim për punën e tyre dhe mirënjohje për angazhimin vetëmohues të të gjithë profesionistëve shëndetësorë. "Kjo vizitë na motivon dhe inkurajon jo vetëm për vazhdimin e kësaj punë, por edhe për ngritjen e gatishmërisë dhe përgatitjen më të mirë për menaxhimin e një vale të mundshme të pandemisë Covid-19 në vendin tonë", ka thënë Krasniqi.

**KMDLNj: Është koha për lehtësim të masave kufizuese**

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të hiqet masa e kufizimit të qarkullimit. Përmes një reagimi për media, ky këshill ka vlerësuar se kufizimi i tillë me vendim të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ishte shpallur se është në kundërshtim me Kushtetutën.

KMDLNj ka bërë me dije se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur vendime jologjike gjatë shqiptimit të dënimeve. "Me miratimin e Ligjit për Pandeminë u sigurua një



gjitha dënimet e shqiptuara në raste të tilla të mos ekzekutohen. Gjithashtu, KMDLNj vlerëson se vendosja e maskave në ambiente të hapura nuk do të duhej të ishte detyruese, kurse në ambiente të mbyllura gjithsesi duhet të vendosen", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij institucioni, kufizimi i lirisë së lëvizjes për persona të moshuar gjatë ditës është treguar kundërproduktive për faktin se nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme të kontrollohet, prandaj kjo duhet të largohet sa më shpejt. Nuk ka asnjë kuptim të vendosni një masë kufizuese të lirisë së lëvizjes për të moshuar në emër të mbrojtjes së shëndetit të tyre, kurse në anën tjetër nuk siguroni falas mjete mbrojtëse parandaluese, nuk siguroni mjete as për mbijetesë minimale, nuk e bëni testin Covid-19 përveç se nëse nuk kanë një intervenim të fortë dhe kushte të tjera parandaluese. Kufizimi i lirisë së lëvizjes nga ora 22.30 deri në orën 6:00 të mëngjesit është veprim krejtësisht i papeshuar dhe i panevojshëm aq më parë që në atë kohë, vetëm në raste të ndonjë emergjence mund të ketë lëvizje", ka vlerësuar KMDLNj.

Më tej, KMDLNj ka përmendur edhe efektet e tjera që kanë shkaktuar masat kufizuese. "Mbyllja e stërzgatur ka prodhuar shumë dëme në sistemin e arsimit në të gjitha nivelet, ka dëmtuar jashtëzakonisht shumë bizneset, ka shuar shumë vende të punës duke rritur numrin e rasteve sociale, ka ndikuar në rritjen e rasteve të dhunës në familje dhe format e tjera të kriminalitetit. Vetëm pas përfundimit të pandemisë të gjitha këto dukuri negative si pasojë e mbylljes do të

bazë ligjore për sanksionim të të gjithë atyre që nuk respektonin masat kufizuese të Qeverisë së Kosovës me rekomandim të IKShPK-së e që për KMDLNj-në kishte vendime jologjike gjatë shqiptimit të dënimeve. Ka qenë krejtësisht e paarsyeshme shqiptimi i dënimit për ngasësin e automjetit që ka qenë i vetëm në makinë apo me anëtarë të ngushtë të familjes dhe nuk kanë vendosur maska mbrojtëse. Për këtë arsye KMDLNj kërkon që të

## Në 24 orët e fundit, asnjë i vdekur nga Covid-19 në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes së njeriut nga Covid-19. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka vlerësuar se situata epidemiologjike me Covid-19 paraqitet stabile, me tendencë të rënies në javët në vazhdim. Sipas IKShPK-së, kjo po ndodh si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike. "Situata epidemiologjike me Covid-19 paraqitet stabile, me tendencë të rënies në javët në vazhdim, si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë

Publike. Gjatë dy javëve të fundit kemi rënie të dukshme të numrit të rasteve 44 për qind. Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe në laboratorët privatë, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 503 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 66 raste pozitive. Brenda 24 orëve nuk është raportuar asnjë rast i vdekjes së njeriut me SARS CoV-2 pozitiv", është thënë në njoftimin për media, duke shtuar se gjatë kësaj kohe janë shënuar 141 pacientë. "Numri total i rasteve pozitive është 15 208 raste nga 63 110 persona të dyshimtë në

virusin SARS-CoV-2 dhe 615 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 141 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shënuarve deri më sot është gjithsej 12 815 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 778. Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 22 raste, komuna Gjilan 8 raste, komuna Deçan 7 raste, komuna Ferizaj 5 raste, komuna Podujevë 5 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Kamenicë 3 raste, komuna Pejë 3 raste, komuna Gjakovë 2 raste, komuna Suharekë 2 raste, dhe me nga një rast komunat Drenas, Istog, Klinë, Kllokot, Rahovec dhe Vushtrri" është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

shpërfaqen në dimensionin e vërtetë. T'i kufizosh bizneset apo edhe të mos lejosh fare disa

biznese në kohën kur deputetët e pashpirtë të Kuvendit të Kosovës nuk e votojnë Ligjin për

Rimëkëmbje Ekonomike, është krejtësisht e pamoralshme dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se të dy qeveritë kanë abuzuar me teste. "Të dy qeveritë, ajo Kurti, që ishte jetëshkurtër, por më efikase në menaxhimin e pandemisë, sikur edhe qeveria Hoti kanë abuzuar me testet, duke bërë dallime diskriminuese në bazë të statusit në shoqëri, atij ekonomik dhe politik, për çka KMDLNj ka reaguar disa herë. Numri i testeve rrallë se ka kaluar 500 për 24 orë e që ka qenë i pamjaftueshëm për identifikim të rasteve aktive dhe ndërmarrje të masave parandaluese" ka vlerësuar ky këshill.



## Ambasada Amerikane: Përmes projekteve të përbashkëta do të hapen mijëra vende pune për të rinjtë

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Të hënën është nënshkruar marrëveshja ekonomike në mes të kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe kryeshefit ekzekutiv të Korporatës Financiare Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (DFC), Adam Boehler. I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit ishte edhe i dërguari i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell.

Këtë marrëveshje e ka përshëndetur edhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, duke thënë se përmes projekteve të përbashkëta do të hapen mijëra vend pune për të rinjtë.

Sipas Ambasadës Amerikane në Prishtinë, vizita e 14 anëtarëve që përfaqësojnë gjashtë agjenci zhvillimore amerikane është e jashtëzakonshme. "Vizita e

djeshme ishte vërtet e jashtëzakonshme. 14 anëtarë që përfaqësojnë gjashtë agjenci të USG vizituan Prishtinën për ta nënvizuar angazhimin e Shteteve të Bashkuara ndaj Kosovës, popullit të saj dhe ndaj marrëveshjes historike për normalizim ekonomik e udhëhequr nga Shtëpia e Bardhë midis Kosovës dhe Serbisë. Lidhjet më të forta përmes projekteve të përbashkëta të infrastrukturave, diversifikimit të energjisë, turizmit dhe bashkëpunimit të sektorit privat do t'i nxisë investimet dhe do të hapë mijëra vende të punës për të rinjtë. Gjatë javëve dhe muajve të ardhshëm, ne shpresojmë të punojmë me partnerët tanë në Qeverinë e Kosovës dhe sektorin privat për t'i zbatuar plotësisht angazhimet e bëra në marrëveshjen e Uashingtonit",

ka njoftuar Ambasada Amerikane në Prishtinë.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka konfirmuar se ministrat e kabinetit qeveritar do të formojnë ekupe të veçanta, të cilat do të pajtohen me ekipet e ShBA-së për zbatimin e projekteve që dalin nga marrëveshja e 4 shtatorit.

Hoti dhe Vuçiqi kanë nënshkruar marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë, në praninë e presidentit Trump. Të dyja palët, megjithatë, nuk i kanë hedhur nënshkrimet në dokumentin e njëjtë, por secila veç e veç i ka nënshkruar zotimet e saj.

Trump, në anën tjetër, ka nënshkruar një letër përmes së cilës i ka përgëzuar palët për guxim drejt normalizimit të marrëdhënieve.



## Misioni i Institutit 'Robert Koch' arrin në Kosovë për të ndihmuar në situatën e Covidit

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Me qëllim të forcimit të kapaciteteve të vendit në luftën kundër Covid-19, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Qendra për Mbrojtjen e Shëndetit Ndërkombëtar (ZIG) në Institutin "Robert Koch" (RKI) kanë dërguar një delegacion në një mision të përbashkët të (RKI/EMT/GOARN) në Republikën e Kosovës. Misioni dyjavor (21 shtator - 3 tetor 2020) është iniciuar dhe organizuar nga RKI në bashkëpunim të ngushtë me OBSH-në dhe Rrjetin Global të Alarmit dhe Reagimit ndaj Shpërthimit (GOARN). IKShPK-ja dhe RKI-ja kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi që nga marsi i vitit 2018. Ekspertët e RKI, duke përfshirë specialistët nga

Departamenti i Epidemiologjisë së Sëmundjeve Infektive, Qendra e Informacionit për Mbrojtjen e Shëndetit Ndërkombëtar (INIG) e ZIG, Njësia e Shëndetit Publik Mbështetur në Dëshmi e ZIG dhe Mbështetja e Laboratorit të Shëndetit Publik e ZIG, përbëjnë pjesën e delegacionit të RKI për të këshilluar në fushat e mbikëqyrjes, epidemiologjisë, komunikimit të rrezikut dhe diagnostikimit laboratorik. Një mision i fushës për vendosjen e mundshme të një laborator mobil është integruar në mision. Sa i përket menaxhimit klinik, qëllimi i misionit është të sigurojë mbështetje dhe këshilla për Ministrinë e Shëndetësisë në Kosovë dhe punëtorët lokalë të kujdesit shëndetësor lidhur me menaxhimin klinik të



pacientëve me Covid-19, si dhe për t'i zbatuar masat e parandalimit dhe kontrollit të

infeksionit (IPC). Për të arritur këtë, ekspertët mjekësorë do të ofrojnë mbështetje për

personelin klinik dhe trajnim lidhur me Covid-19 në vendin e punës.

## Grupi i Grave Deputete mbajti dëgjim publik për Projekt Kodin Civil

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Grupi i Grave Deputete, në bashkëpunim me Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, të martën ka mbajtur dëgjim publik me temën "Mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes Projekt Kodit Civil". Në këtë dëgjim publik, në të cilin ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga shoqëria civile, u theksua nevoja e miratimit sa më të shpejtë të Kodit Civil në Kuvendin e Kosovës, por edhe



përfshirja e të gjitha palëve në amendamentimin e tij. Kryetarja e Grave Deputete, Vlora Limani-Hajnuni, tha se prioritet i Kuvendit është miratimi sa më parë i Kodit Civil. Ndërsa kryetari i Komisionit për Legjislacion,

Mandate, Imunitete, Rregullore të Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Shkëmb Manaj, tha se pas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kodi Civil është akti më i rëndësishëm që nxjerr Kuvendi i Republikës së

Kosovës.

Në anën tjetër, përfaqësues nga shoqëria civile janë shprehur të pakënaqur me mospërfshirjen dhe mosmarrjen parasysh të sugjerimeve të tyre nga ana e grupit punues qeveritar, i cili ka hartuar Kodin Civil, raporton "Epoka e re". Në lidhje me këtë, deputetët u zotuan se do t'i marrin parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me përmbajtjen e Kodit Civil.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Shkëmb Manaj, tha se të gjithë anëtarët e komisionit janë të përkushtuar që të bëjnë më të mirën e mundshme në lidhje me Kodin

Civil, me qëllim që i njëjti sa më parë të dërgohet në seancë për votim.

Në korrik të vitit 2020 Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë ka bërë prezantimin e Projekt Kodit Civil, përmes të cilit synohet të bëhet rregullimi dhe harmonizimi i dispozitave ligjore të së drejtës civile, si Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, Ligjit të Pronësisë dhe të Drejtave të Tjera Sendore, Ligjit të Familjes dhe Ligjit të Trashëgimisë.

Në këtë dëgjim publik kanë marrë pjesë përfaqësues nga NDI-ja, OSBE-ja, UN Women, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë etj.

## Përrurohet salla për zhvillimin e procedurave rekrutuese për nëpunësit civilë

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, të martën ka bërë përrurimin e sallës për zhvillimin e procedurave rekrutuese për nëpunësit civilë. Gjatë kësaj ceremonie ministri Veliu ka theksuar se, krahas përgatitjeve të nevojshme për aktet nënligjore dhe teknike për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike, janë bërë edhe përgatitjet për fillimin e zbatimit në praktikë të Ligjit për Zyrarët Publikë. Me këtë rast, Ministria e

Punëve të Brendshme ka krijuar sistemin i cili do të shërbejë edhe si portal pune, i emëruar "Konkursi", të cilin do ta përdorin të gjitha institucionet publike. Ndërsa për lëvizje paralele brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë, ka krijuar edhe Qendrën Testuese/sallën për zhvillimin e procedurave rekrutuese, e cila mund të përdoret edhe nga institucionet e tjera derisa ato të krijojnë kushte infrastrukturore për menaxhim dhe zhvillim të këtyre procedurave.



# 22 vjet nga rënia e heronjve Fehmi e Xhevë Lladrovci, përkujtohet lufta dhe sakrificat e tyre

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

DRENAS, 22 SHTATOR - Të martën janë bërë 22 vjet nga rënia heroike e komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe bashkeshortës së tij, luftëtare e UÇK-së, Xhevë Krasniqi-Lladrovci. Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, përvjetori i rënies së heronjve Lladrovci është shënuar me disa aktivitete ndryshe nga vitet e paraprake.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me stafin e tij, nënkryetarin e komunës, Nazmi Hasi, drejtoreshën e Agjencisë për Zhvillim Rajonal - Qendër (AZhR), Mrika Gashi-Macula, drejtor të drejtorive komunale, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj dhe anëtarë të Kuvendit, Shoqatat e

Dala nga Lufta e UÇK-së e bashkëveprimtarë të tjerë, kanë vendosur buqeta me lule të freskëta dhe kanë bërë homazhe në sheshin 'Fehmi Lladrovci' para shtatoreve dhe te varrezat e dëshmorëve në fshatin Gllanasellë. Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka kujtuar luftën heroike të gjithë dëshmorëve dhe sakrificën e tyre, duke thënë se puna e mirë dhe transparente është zotim i përbushur mbi idealet e tyre.

Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin i kanë përkujtuar edhe përfaqësuesit e institucioneve të shtetit. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se Fehmi dhe Xhevë Lladrovci ishin pjesë e formacioneve të para të UÇK-së për organizimin e rezistencës së armatosur dhe figura emblematike të luftës sonë çlirimtare. "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, dy prej veprimtarëve më të hershëm të



lëvizjes ilegale për liri dhe pavarësi, ishin Azem dhe Shotë Galica e kohës sonë. Ata ishin pjesë e

formacioneve të para të UÇK-së për organizimin e rezistencës së armatosur dhe figura emblematike të luftës sonë çlirimtare. Me krenari e kujtoj çdo moment të angazhimit tonë të përbashkët", ka thënë Thaçi.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se 22 vjet më parë Fehmi dhe Xhevë Lladrovci u shndërruan jo vetëm në heronj të Kosovës, por në rrëfimin që do ta mbijetojmë brezat për çiftin dëshmor. "Siç e kaluan bashkë gjithë jetën, vazhduan edhe në luftë duke e transformuar aktivitetin e tyre kombëtar në luftë për çlirimin e vendit për të cilën nuk pushuan deri në frymën e fundit. Në betejën e Çiçavicës u takuan së fundi e po aty ranë të dytë për t'u shndërruar në referencë të lirisë sonë, në kurajë dhe në inspirim se për lirinë gjithçka ka kuptim. Xheva me

Fehmiun janë kuptimi i lirisë sot, janë amaneti i brezave dhe thirrje që shtetin ta bëjmë siç deshën ata! Kujtim përherë për Xhevën e Fehmiun dhe për të gjithët gratë e burrat dëshmorë që e bënë të mundshme lirinë tonë", ka thënë kryetarja Osmani.

Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se rënia heroike e Fehmi e Xhevë Lladrovci dhe bashkëlufëtareve të tyre na kujton përkushtimin dhe sakrificën e madhe për liri, pavarësi dhe demokraci. "Pushka e tyre shkrepri për ta mbrojtur pragun e shtëpisë dhe ekzistencën e popullit tonë, andaj edhe bashkësia ndërkombëtare ishte aleate e fuqishme e luftës sonë të drejtë", ka deklaruar Hoti.

Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin i kanë përkujtuar edhe bashkëlufëtare të tij dhe kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati.



## Reçica i vendosur për njohjen e stazhit të punës për punonjësit e larguar me dhunë gjatë viteve '90 nga pushteti serb

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të martën në takim përfaqësues të Këshillit Drejtues dhe Sindikatës së Pavarur të Ndërmarrjes Shoqërore Gazetare "Rilindja", me të cilët ka diskutuar lidhur me njohjen e stazhit të punës të viteve '90, që përfshinë edhe punëtorët e kësaj ndërmarrje. Përfaqësuesit e Këshillit Drejtues dhe Sindikatës së Pavarur të

"Rilindjes", ministri Reçica i ka informuar për të gjitha nismat e tij reformuese që ka ndërmarrë, veçmas lidhur me njohjen e stazhit të punës për punonjësit e larguar me dhunë në vitet '90 nga pushteti serb, nismë kjo që tashmë ka marrë rrugë, pasi që është hartuar plotësim-ndryshimi i ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, ku parashihet edhe njohja e stazhi në fjalë.

Gjithashtu, në këtë takim është diskutuar edhe për Reformën e përgjithshme pensionale, që në

fokus do ta ketë adresimin e të gjitha shqetësimeve të qytetarëve, punonjësve dhe pensionistëve, duke instaluar edhe sistemin e sigurimeve sociale. "U jam tejet mirënjohës për gatishmërinë e tyre për të qenë krah nesh në këtë proces, për t'i shtyrë para reformat që kam ndërmarrë si ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe prioritetet që janë në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të vendit", ka thënë ministrit i MPMS-së, Skender Reçica.





## Ministri Krasniqi sheh nga afër ndarjen e produkteve bimore dhe shtazore

PRISHTINË, 21 SHTATOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, së bashku me inspektorët e tregut kanë bërë inspektime në disa qendra tregtare për të parë se sa po zbatohet vendimi i kësaj ministrie, i cili ndalon përkohësisht importimin e vajit të palmës dhe produkteve me përmbajtje të këtij vaji. Pas inspektimit në super-market "Viva fresh story" në Veternik

dhe në "MAXI 24", në rrugën B në Prishtinë, ministri Krasniqi është shprehur i kënaqur me zbatimin e këtij vendimi. "Sot ishim për vizitë te disa pika tregtare në Prishtinë për të parë nga afër se sa po zbatohet vendimi i nxjerr nga ana ime, më 11 shtator e që ka hyrë në fuqi nga data 15 shtator, si arsyeshmëri e kësaj është përdorimi i yndyrës apo vajit të palmës. Ne sot nga afër pamë ndarjen e produkteve

bimore dhe shtazore se sa po e zbatojnë këtë vendim marketet tona. Nga ajo që pamë deri më tani, jemi të kënaqur dhe vendimi ka filluar të zbatohet në përpikëri", ka deklaruar ministri Krasniqi.

Ministri Krasniqi ka njoftuar se me vendim është ndaluar importi i të gjitha produkteve që kanë përmbajtje të vajit të palmës. "Sigurisht ky vendim është i përkohshëm. Ne me

Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës kemi bërë të gjitha përgatitjet, kemi marrë mostra të disa prej produkteve që kanë përmbajtje të vajit të palmës dhe janë shitur si produkte të qumështit. Me këto veprime dhe vendime duam ta sigurojmë konsumatorin se çfarë produkte po konsumon", është shprehur ministri Krasniqi.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, më 11.09.2020 ka

marrë vendim për ndalimin e përkohshëm të vajit të palmës dhe importit të djathit dhe produkteve të ngjashme të djathit me yndyrë bimore (vaji i palmës). Me këtë vendim, po ashtu, obligohen mekanizmat inspektues të institucioneve të Kosovës t'i obligojnë operatorët ekonomikë që ta bëjnë ndarjen e produkteve të qumështit me yndyrë bimore prej atyre me origjinë shtazore.

## Kuçi premtan mbështetje në "Infrakos" për marrëveshjen financiare për subvencionim

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka vizituar të martën Ndërmarrjen Publike të Infrastrukturës së Hekurudhave "Infrakos". Ministri Kuçi u prit nga u.d. kryeshefi i ndërmarrjes, Xhevat Ramosaj dhe pjesa tjetër e menaxhmentit të kësaj ndërmarrje. Shumë halle dhe probleme të "Infrakos"-it u

shpërfaqen para ministrit, kurse theksi u vë te vonesa shumëvjeçare e një marrëveshje financiare për subvencionim të kësaj ndërmarrje që buron nga Ligji i Hekurudhave.

Ministri Kuçi ka shprehur gatishmërinë e tij që ta shtyjë përpara këtë marrëveshje bashkë me ministrin Arban Abrashi. "Për fat të keq, si shumë ndërmarrje publike, edhe kjo ndërmarrje ka probleme financiare dhe ka

obligime të ndryshme. Por, ne e kemi në dorë një marrëveshje që është obliguese nga ligjet përkatëse, do të shikojmë edhe me ministrin Abrashi që, ndoshta, jemi afër për ta nënshkruar një marrëveshje të tillë, që i garanton pjesën operative të funksionimit të "Infrakos", ka thënë Kuçi.

Bashkë me zyrtarët e "Infrakos"-it, ministri Blerim Kuçi vizitoi edhe punishten në Miradi, ku po

punohet në projektin e rehabilitimit gjeneral të Linjës së 10-të hekurudhore në fazën e parë Fushë-Kosovë - Han i Elezit - Kufi me Maqedoninë. Udhëheqësit e projektit prezantuan punën që po bëjnë, teksa u tregua që pandemia Covid-19 kishte pasur gisht në vonesat e projektit. "Për shkak të Covid-it kemi një dinamikë jo të planifikuar, por po besoj se kohën e fundit me intensitetin dhe dinamikën e

punëkryesit nuk do të kemi probleme të mëdha sa i përket dinamikës. Në aspektin financiar ky projekt nuk ka probleme. Është i rëndësishëm së veçantë. Shkon prej Fushë-Kosovës në drejtim të Maqedonisë. Ka shumë objekte brenda këtij projekti që janë të rëndësishëm së veçantë. Ajo çka është me rëndësi, po krijohet një hekurudhë me standarde të BE-së, që ka qenë më se e nevojshme", ka thënë Kuçi.





## Qumështarët anulojnë protestën e paralajmëruar

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Shoqata e Fermerëve Kosovarë e Qumështit ka njoftuar se ka anuluar protestën e paralajmëruar, pasi është shtyrë deri më 1 tetor vendimi për pranimin e qumështit. "Në takimin e mbajtur me ministrin e Bujqësisë, Besian Mustafa, drejtorin e Qumështores 'Vita', përfaqësues të Shoqatës së Fermerëve Kosovarë të

Qumështit, përfaqësues të pikave grumbulluese të qumështit, kemi vendosur ta anulojmë protestën e paralajmëruar më 23 shtator. Duke u bazuar në zotimet e ministrit Mustafa, se janë duke vepruar si qeveri se shumë shpejt ky problem të zgjidhet, po ashtu drejtori i Qumështores 'Vita', duke u bazuar në premtimet e qeverisë, e anulujmë vendimin

me të cilën ditën e hënë (21 shtator) parashihej ndërprerja e pranimin të qumështit si nga fermerët, po ashtu nga pikat grumbulluese. Vendimi për pranimin e qumështit do të zgjatet deri më 1 tetor, me mundësi të rishqyrtimit të këtij vendimi nëse qeveria merr hapa konkretë", thuhet në njoftimin e Shoqatës së Fermerëve Kosovarë të Qumështit.



## Sektori i hotelerisë pranë kolapsit, 17 000 persona rrezikojnë të mbesin pa punë

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Oda Hoteliere dhe Turistike e Kosovës ka paraqitur shqetësimet e tyre për vendimet e qeverisë për këta sektorë. Kryetari i kësaj ode, Hysen Sogojeva, në një konferencë për media ka thënë se kërkesat e këtij sektori janë heqja e kufizimeve dhe kalimi i Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike pasi që, siç thotë ai, nga pandemia 85 për qind e këtij biznesi është në kolaps dhe se

afër 17 000 persona e kanë humbur punën.

Sogojeva ka thënë se humbja financiare vetëm në dasma parashihet të jetë rreth 600 milionë euro, derisa ka folur edhe lidhur me vendimet e marra të qeverisë në kohën e pandemisë. "Nëse shkojmë me shifër, rreth 85 për qind e këtij biznesi është në kolaps, e nëse e marrim në total, diku 20-25 mijë punëtorë punojnë në këtë sektor, do të thotë vetëm në këtë sektor rreth 16-17 mijë punëtorë mund të mbesin pa punë. Humbjet janë të

mëdha. Vetëm dasmat që i kemi llogaritur janë 600 milionë euro", ka thënë ai. Ai i ka quajtur të gabuara të gjitha vendimet e qeverisë pasi, sipas tij, nuk i ka marrë parasysh kërkesat e Odës Hoteliere dhe Turistike të Kosovës, derisa thotë se i kanë ndërmarë të gjitha masat për mbrojtje nga pandemia Covid-19.

Mosvotimin e Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike nga ana e deputetëve, Sogojeva e ka quajtur vendim të turpshëm. Ai ka thënë se duhen të hiqen të

gjitha masat dhe duhet të lirohen njerëzit që të punojnë, sepse ai thotë se shteti i Kosovës mbahet nga taksat e këtyre bizneseve. Sogojeva ka lutur qeverinë dhe deputetët që ta votojnë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike sa më shpejt, përndryshe janë në gjendje t'i qesin në protestë 20 000 persona. Ndërsa këngëtarin Afrim Muçiqi ka thënë se me mosvotim të Projektligjit për Rimëkëmbje Ekonomike po përdoren standarde të dyfishta. "Pse është përdorur standard i dyfishtë për

estradën, për sallat e dasmave, për bizneset që janë industri jashtëzakonisht e madhe. Me këtë standard të dyfishtë e kanë shkatërruar një ekonomi të tërë e cila do të ketë kohë edhe vite për rimëkëmbje", ka thënë Muçiqi, duke shtuar se politikanët që nuk po votojnë Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike nuk ia duan të mirën këtij vendi. "Deputetët të mos luajnë me dinjitetin e njerëzve. Apeloj të gjithë votuesit që tash e tutje të hapin sytë dhe të shikojnë kujt po ua japin votën", ka thënë Muçiqi.



## Posta lëshon në qarkullim tri pulla postare me imazhet artistike të Tahir Emrës

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Në kuadër të tematikës "Arti vizual - Tahir Emra", filatelia e Postës së Kosovës ka lëshuar në qarkullim tri pulla postare me imazhet artistike të piktorit të shquar, Tahir Emra, të tituluara: Vatra-oxhaku, Piknik në Çabrat dhe Peizazh. "Piktori Emra që nga fillimi kishte një rrugëtim të sigurt në formësimin e tij me shprehje

përmbajtjesore, i cili hyri në mesin e krijuesve të mëdhenj që patën idealizmin e theksuar, e që vizatimin e pati përherë si pikënisje të lartë për realizimin e veprave të larta artistike. Ngjyra, për piktorin Tahir Emra, është alfa dhe omega e shpërfaqjes së tij kreative në pikturë, që për 60 vjet krijimtari rrugëtoi sigurt nëpër faza. Këtë sens e vëre-

jmë edhe në peizazhet nga vendlindja e tij Gjakova, mbi Çabrat, të cilit i kushtoi poezi me ngjyra në mënyrën më të lartë pikturore", thuhet në njoftimin e Postës së Kosovës. Në këtë njoftim theksohet se filatelia e Postës së Kosovës do të angazhohet që përmes imazheve të pullave postare t'i afirmojë vlerat tona artistike dhe kombëtare.



## Përurohet projekti i efijencës së energjisë në shkollën 'Vesel Muja' të Gjilanit

**GJILAN, 21 SHTATOR (ER)** - Është mbajtur ceremonia e përuimit të Projektit "Intervenimi me masa inovative efijente të energjisë në shkollën 'Vesel Muja' në Mihir të Gjilanit, projekt ky i pari i këtij lloji në fushën e efijencës së energjisë në Kosovë. Ky projekt është realizuar në kuadër të sektorit të EE si dhe bashkëfinancuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe financuar nga GIZ Gjermani përmes Asociacionit të Komunave të Kosovës

Valbona Tahiri, drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik në Gjilan, i ka falënderuar GIZ-in dhe AKK-në për mbështetjen e dhënë pasi ky projekt ka ndikim edhe në promovimin e menaxhimit të energjisë në nivel lokal. "Unë jam e kënaqur që përmes këtij projekti është investuar me masa inovative të EE-së në këtë shkollë si ventilimi inteligjent është pilotuar për herë të parë në Kosovë. Ky projekt ka përfunduar me sukses, kështu që nxënësit dhe mësuesit

do të kenë një mjedis të përmirësuar të të mësuarit pasi kemi arritur ta kthejmë këtë objekt shkollor në objekt eficient", ka thënë Tahiri. Në ceremoninë e inaugurimit edhe Nazim Gagica, drejtor i Arsimit, ka falënderuar donatorët për mbështetje komunës si dhe u ka uruar suksese mësuesve, nxënësit dhe prindërve të kësaj shkolle. Arsim Osmani nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe



përfaqësuesi nga GIZ, Maliq Pireci, si dhe drejtori i shkollës kanë shprehur mirënjohje dhe gatishmëri për realizimin e iniciativave potenciale të ngjashme edhe në të ardhmen.

## AZhR-ja ofron përkrahje për bizneset në Drenas



**DRENAS, 22 SHTATOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të martën ka pritur në takim drejtoreshën e Agjencisë për Zhvillim Rajonal - Qendër (AZHR), njëherësh kryesuese e Bordit të AZhR-së, Mrika Gashi-Macula. Lladrovci ka falënderuar drejtoreshën Macula për

përkrahjen e vazhdueshme që është duke ua dhënë AZhR-ja bizneseve të Drenasit dhe ka shtuar se bashkëpunimi për t'i mbështetur bizneset do të vazhdojë edhe nga Komuna e Drenasit. Drejtoresha e AZhR-së, Mrika Gashi-Macula, ka falënderuar kryetarin Lladrovci për pritjen, duke shtuar se mbështetja e

bizneseve të dëmtuara gjatë pandemisë do të jetë e vazhdueshme. Gjithashtu, ajo ka shtuar se mbështetja edhe e të rinjve do të jetë në trajnime të ndryshme për t'u përgatitur në punën e tyre profesionale. Macula, po ashtu, ka uruar kryetarin Lladrovci për vendin e parë në performancën komunale.

## Aliu nderohet me mirënjohje me rastin e 20-vjetorit të "RTV Festina"

**FERIZAJ, 22 SHTATOR (ER)** - Mediat lokale kanë pasur dhe do ta kenë vazhdueshëm përkrahjen e qeverisjes lokale, e gjitha kjo në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies para qytetarëve. E tillë ishte edhe "RTV Festina", që për dy dekada rrugëtoi bashkë me rrjedhën e zhvillimeve në Ferizaj e më gjerë.

Në jubileun e 20 të "RTV Festina", pronari i saj Besnik Berisha i ndau mirënjohje të parit të Ferizajt, Agim Aliu, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e ofruar për "RTV Festina". Kryetari Aliu u shpreh falënderues për gjestin mirënjohës, duke thënë se kjo media ka



dhënë kontribut të çmueshëm tash e dy dekada në sferat e ndryshme shoqërore që ka trajtuar si medium përgjatë harkut kohor 20-vjeçar.

## Kompletohet infrastruktura në disa rrugë të qytetit të Podujevës

**PODUJEVË, 22 SHTATOR (ER)** - Nën kryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka vizituar punimet në asfaltimin e rrugëve "Anton Çeta" dhe "Qefser Sadiku" në qytet. Pas vizitës, që kishte për qëllim

inspektimin e punimeve në këto rrugë, nënkryetari Rudari u shpreh i kënaqur me dinamikën e realizimit të projektit. Me këtë rast nënkryetari Rudari ka thënë se në këtë pjesë të

qytetit ditë më parë ka përfunduar edhe projekti i ndriçimit publik. Ai ka theksuar se këto projekte do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe lehtësimin e qarkullimit të qytetarëve.



## Filloi ndërtimi i trotuarit në Senik të Malishevës

**MALISHEVË, 22 SHTATOR (ER)** - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale dhe realizimit të planit të investimeve, në fshatin Senik të Komunës së Malishevës ka filluar ndërtimi i trotuarit 1.5 kilometër i gjatë që e lidhë një pjesë të madhe të fshatit me shkollën.

Në fillimin e punimeve për ndërtimin e këtij trotuari morën pjesë i pari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina dhe drejtoresha e



Administratës, Besartë Kryeziu-Ramaj, e të cilët janë pritur nga kryetari i fshatit Senik, Besim

Ramaj. Pasi është njoftuar me projektin, kryetari Begaj i ka uruar banorët e

fshatit Senik për realizimin e këtij projekti që ka rëndësi të madhe, sidomos për fëmijët, të cilët çdo ditë udhëtojnë për në shkollë dhe me ndërtimin e trotuarit, u krijohet siguri më e madhe në lëvizje. "Besoj se me ndërtimin e trotuarit krijohet një siguri më e madhe për të gjithë ata që ecin përgjatë rrugëve në fshat, e sidomos për fëmijët të cilët janë më të rrezikuar gjatë udhëtimit për në shkollë. Ju banorë të Senikut, ta gëzoni këtë

projekt, ndërsa ne si komunë do të vazhdojmë të angazhohemi për realizimin e nevojave dhe kërkesave të të gjithë banorëve të Komunës së Malishevës", ka thënë kryetari Begaj. Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, ka sqaruar se trotuari është i gjatë 1.5 kilometër dhe mbulon një pjesë të madhe të fshatit, ndërsa ndërtimi i trotuarit mundësohet nga buxheti i Komunës së Malishevës.

# SI PO KRIJOHEN PROBLEMET KOMBËTARE E SHOQËRORE



Nga Jakup KRASNIQI

Pa asnjë dyshim shoqëria njerëzore ka arritur suksese në shumë fusha të jetës politike, kulturore, arsimore, shëndetësore, shkencore dhe zhvillimore. Të gjitha këto janë rezultat i energjive pozitive të njerëzve mendjehapur që kanë shikuar e punuar për një të ardhme më të mirë, më të begatë e më lehtësuese për shoqërinë njerëzore.

Për dallim nga energjitë pozitive, shoqërinë njerëzore e kanë përcjellë dhe po e përcjellin edhe sot energji negative, që jo pak herë e kanë rrezikuar ekzistencën e shoqërisë njerëzore. Dëme të mëdha i kanë shkaktuar e vazhdojnë t'i shkaktojnë njeriut dhe shoqërisë edhe sot e kësaj dite. Energji negative për shoqërinë prodhon edhe "dashuria" e njerëzve për vetveten dhe kombit që i përkasin. Kjo "dashuri" i pengon njerëzit që ta shohin interesin e individit tjetër apo të kombit tjetër. Energjia negative rezulton e rrezikshme sidomos kur politika shtetërore bëhet qendra e përhapjes së saj, në këto raste energjia negative (dashuria për kombin tim hyjnor) prodhon shumë

urrejtje për kombet e tjera dhe zakonisht në raste të tilla nacionalizmi bëhet i egër dhe prodhon politika të krimit e të gjenocidit. Kjo formë e nacionalizmit të egër në rajonin e Ballkanit është shfaqur në shekullin XIX, ka vazhduar në shekullin XX në Serbi, sidomos u rishfaq me egërsi të shtuar në mesin e viteve '80 në Projektin e AShAS-së. Ndërsa kulmin e arriti në vitet '90. Në këto vite u shkaktuan më se tri luftëra që popujve të Federatës Jugosllave, të udhëhequra nga Serbia. Shqiptarët, boshnjakët e kroatët përjetuan gjenocidin që Serbia e Millosheviqit ushtroi mbi këta popuj që me dekada kishin bashkëjetuar. Kishin bashkëjetuar me gjarprin me zile në gjil! Këto luftëra konfirmuan se ajo bashkëjetesë ishte e dhunshme, edhe pse për vite ishin paketuar si politika të bashkim-vëllazërimit! Krijesat federative të sistemit socialist në Evropë askund nuk përfunduan me luftëra si në shpërbërjen e federatës jugosllave.

"Dashuria" për vetveten e popullit serb, e krijuar nga miti i rrejshëm serb, e pamë sesi shndërrohet në urrejtje për të tjerët deri në politika të krimit e të gjenocidit. Këtë "dashuri" ne shqiptarët e tejkaluam disi, është mirë që ia lamë historisë, ndonëse atë histori të dhimbshme nuk mund e nuk guxojmë kurrë që ta harrojmë. Tani, që njëzet, përkatësisht

dhjetë vjet pas pavarësisë, cila dashuri po na e rrezikon të sotmen e të ardhmen tonë njerëzore e kombëtare? Sot, njeriun e kombin tonë është duke e rrezikuar dashuria për grykësinë personale, për njerëzit e klanin që i përket a i përkas, dashuria për mendimin që kam a që ke, për politikën që e ushqej a e ushqen, për qeverisjen që e ushtroj apo e ushtrojmë, qeverisje thjesht për përfitime personale. Me këto dashuri që i kultivuan pas Pavarësisë, çka i ndihmuan njeriut tonë, bashkëkombësve tanë dhe pasurisë së vendit tonë? Si ta quajmë këtë dashuri? Dashuri apo grykësi? Mbase, ta quajmë më saktë, dashuri për grykësi! "Dashuri" e cila njerëzve tanë u ka shkaktuar e po u shkakton dhimbje të mëdha. U ka shkaktuar humbje të shpresës e të besimit, ua ka mbjellë në kokë paperspektivën për jetën në atdheun e tyre. Kjo ka bërë që shpresën e perspektivën ta shohin në ikje nga atdheu i tyre aq i dashur. Edhe pse kjo dashuri është zvetënuar shumë! E atdheut nuk i mjafton vetëm dashuria e qeveritarëve, por dashuria e përkushtimi i së paku shumicës së qytetarëve të tij.

Përfaqësuesit e mandatuar të popullit e kanë marrë mandatin nga qytetari që të qeverisin për të mirën e qytetarëve, që të qeverisin me paranë e pasurinë e tij, për t'i siguruar arsim e edukim cilësor, për të zhvilluar vendin,

për punë, siguri e drejtësi (gjyqësi), për kulturë e shëndetësi, për një jetë më se të dinjitetshme. Koha është që ta mbyllim një praktikë që nuk na dha besim e siguri dhe ta fillojmë një praktikë tjetër për mandatimin e njerëzve, por kjo nuk bëhet duke fryrë balona politikë, siç kemi bërë që gati tridhjetë vjet, por duke ua dhënë mandatin për qeverisje njerëzve të dinjitetshme, njerëzve që kanë dije e dashuri për njeriun, për kombin e shtetin! Ne nuk i kemi respektuar dhe nuk po i respektojmë njerëzit e dinjitetshëm, njerëzit që kanë dhënë dëshmi të shumta për dijen e dashurinë për vendin e kombit që i përkasim. Këta njerëz i kishim në vendin tonë, por nuk deshën të shihen nga njerëzit e meritave të luftës. Pa dyshim, ata të luftës kishin merita për lirinë e çlirimin, por nuk kishin dije e përvojë për të qeverisur e bërë politikë për të mirën e kombit, ashtu siç ditën për vete.

Shkurt: Problemet shoqërore në demokraci nuk krijohen vetëm nga një pakicë, ato krijohen nga shumica që mandaton njerëzit për të qeverisur me dije e dashuri për kombin e shtetin. Vetëm njerëzit e papërgjegjshëm, që mandatohen nga shumica qytetarëve të pavëmendshëm i krijojnë problemet shoqërore, fillimisht në shkallë kombëtare e pastaj edhe në shkallë rajoni dhe përtej tij. Këtë e kemi parë dhe e kemi të freskët në kujtesë, se çka

ndodhi kur populli serb i dha mandat Millosheviqit për t'i luftuar të gjithë të tjerët që i konsideronte kundërshtarë të interesave serbe. Madje, që dhjetë vite edhe ne po e shohim sesi bëhet mandatimi i të papërgjegjshmëve, çfarë probleme po i shkaktojnë shoqërisë e shtetit tonë. Kosova para qershorit të vitit 1999 kishte probleme që nuk vareshin vetëm nga uniteti i brendshëm kombëtar. Pas qershorit të vitit 1999, e sidomos pas Pavarësisë më 17 shkurt 2008, problemet e Kosovës kryekrejt janë tek mosdefinimi i qartë nga politika jonë (pozitiv - opozitiv), e cila nuk po e definon e as po e dallon qartë interesin kombëtar e shtetëror nga ai zgjedhor.

Politika e çakorduar e Kosovës në dhjetë vjetet e fundit, qeverisja e keqe, mosmundimi i rendit dhe i ligjit, mosndëshkimi i krimit ekonomik dhe i korrupsionit (gjatë gjithë periudhës së pasluftës), kanë bërë që Kosova për shumëçka të trajtohet si Serbia, madje edhe sa iu përket krimeve të luftës! Ani pse Serbia ka udhëhequr politika të gjenocidit ndaj tre popujve, shqiptarëve, kroatëve e boshnjakëve. Dhe çuditërisht, nga drejtësia ndërkombëtare nuk pati ndonjë gatishmëri për ta dënuar Serbinë për gjenocid! Në këtë mënyrë Serbia u amnistua për t'i paguar dëmet e luftërave. Dëme që janë shkaktuar në ditët me diell, me pasojat e të cilave dëme po jetojmë edhe sot e gjithë ditën.

## HOTI: VENDIT I NEVOJITET NJË STRATEGJI NACIONALE E REFORMIMIT TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

PRISHTINË, 22 SHTATOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, të martën është takuar me ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj dhe me kryetarin e Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, me të cilët ka biseduar për gjetjen e një zgjidhjeje pas gjendjes së krijuar në arsimin parauniversitar të kësaj komune si pasojë e mosvijimit të procesit mësimor nga nxënësit e disa shkollave. Fillimisht, kryeministri Hoti e ka përgëzuar kryetarin Kastrati për nismën e ndërmarrë, me qëllim të reformimit dhe avancimit të arsimit në këtë komunë, duke theksuar se vendit i nevojitet një strategji

nacionale e reformimit të sistemit arsimor parauniversitar. Mirëpo, kryeministri Hoti, po ashtu, ka theksuar se institucionet e vendit, qendrore dhe lokale, janë të obliguara të krijojnë kushte për përfshirjen e të gjithë nxënësve në procesin mësimor.

Prandaj, nga ministri Likaj dhe kryetari Kastrati ai ka kërkuar që të shqyrtohen të gjitha mundësitë, në mënyrë që nxënësit e shkollave, të cilat nuk janë duke mbajtur mësim, të rikthehen sa më shpejt në mjediset shkollore, ndërkohë që institucionet e vendit zotohen se do të punojnë për një reformë të përgjithshme të



sistemit arsimor me domosdoshmërinë e ndërtimit të një sistemi edukativ arsimor bashkëkohor,

sipas standardeve më të larta të vendeve të zhvilluara evropëroëndimore.

# Në shtëpinë e nobelistit të parë, Sully Prudhomme



**Nga: Mimoza KUCHLY**

Nuk ishte rastësi që kalova disa ditë në banesën ku kaloi vitet e fundit të jetës dhe dha shpirt nobelisti i parë më 1901, René-François-Armand Prudhomme, ose i njohur nga lexuesit si Sully Prudhomme. Më 6 shtator mbushen 113 vjet nga ditëvdekja e tij.

Më pëlqen të ndjek gjurmët e shkrimtarëve të mi të pëlqyer dhe Prudhomme bën pjesë në këtë grup e aq më tepër që ndodhet njëzet kilometra nga Parisi.

Para se të hysh në ambiente të cilat mbartin një histori dhe muret i ruajnë me fanatizëm, ndeshesh me një pllakë e cila ka memorizuar kohëqëndrimin e tij. Në hyrje më prët një zotni rreth diku të shtatëdhjetave, i gjatë me flokë të bardha që duket se i përshtatet mjedisit. Është pronari i parë pas zonjës e cila kishte jetuar më pranë familjes Prudhhome.

Kur i kërkova që të bënte udhërrëfyesin e mjedisit, m'u duk i emocionuar. Kuptohet nuk isha e para turiste që vija aty, por ajo që i bëri përshtypje ishin njohuritë që kisha rreth poetit nobelist si e huaj, vend nga i cili nuk kishte shume informacion veç nominuesit shqiptar në letërsi, Kadaresë.

Kisha zgjedhur suitën që dikur ishte zyra e punës së nobelistit i cili pas marrjes së çmimit Nobel më 1901, u largua nga Parisi i zhurmshëm dhe gjeti paqe në banesën ku që në hyrje të tërheq kopshti me pemët dhe lulet si në kohën e shëtitjeve të Prudhhome me karrocën e tërhequr nga një

pulisht.

“Vende me histori që po t'i ndryshosh duket se brezat do të na dënojnë”, më thotë duke më treguar hapësirë pas hapësire shtëpinë e nobelistit, i cili kishte jetuar me të motrën dhe nipin deri në fund të jetës së tij. Të nesërmen që herët bashkë me servirjen e mëngjesit, më solli një dosje të madhe ku gjendeshin gazeta dhe shkrime rreth nobelistit. “I kam nxjerrë nga pluhuri dhe nuk kanë parfum fort të këndshëm”, më foli duke më shpjeguar datat dhe ndonjë anekdotë nga jeta e poetit. Nuk ka qenë kurorëzuar në kishë, por i kurorëzuar me çmimin të nderuar që ëndërron një shkrimtar gjithë jetës së tij. Nga fundi i jetës për shkak të studimit të thellë të filozofisë, që sinqerisht herë-herë më duket ekuacion pa zgjidhje, thonë se sa të forta i kishte krizat aq fortë rezistonte”.

Sully, siç e njohim të gjithë këtë pseudonim, e ka nga një mik i të atit i cili rastësisht e kishte thirrur kur ishte bebe dhe ai po ashtu u njoh prej të gjithëve.

Nobelisti e filloi jetën si inxhinier, “por që nuk ishte profesion për mua” e më pas si ndihmës në një kabinet noterial të cilin e braktisi duke i hyrë poezisë dhe udhëhequr nga letërsia.

“Më duket se nuk isha i aftë të bëja gjë tjetër veçse poezisë, do të shprehej nobelisti. Studimet filozofike më bënë që t'i shkoja më thellë letërsisë, më tërhoqën kurse ato psikologjike më pasiononin”.

Në moshën 26 vjeçare ai publikon vëllimin e parë “Strofa dhe poema”, ku spikati sinqeriteti dhe harmonia në formë dhe

përmbajtje. Më vonë, më 1869 do të publikojë “Vetmia” ku e ndjek suksesi i menjëhershëm, pas “Natyra e gjërave”, “Vazo e thyer” dhe vazhdon me përkthimin e poemës “Lukrecia”, me një parathënie e cila është një ndër pjesët më të bukura të letërsisë filozofike.

Poemat e tij, ndiqnin njëra-tjetrën dhe falë punës së vazhdueshme e po ashtu të suksesshme, më 1881 zgjidhet dhe anëtar i Akademisë franceze. Duke shfletuar shënimet dhe dokumente të cilat nuk i kisha gjetur në internet, në ato pak intervista të lëna prej tij, ndihet thjeshtësia e një poeti të madh i cili i fal lexuesit përveç shumë poezive “Ditarin” dhe Mendime Filozofike të cilat e kanë bërë poetin të paraqitet para lexuesit me gjithë bagazhin e tij letrarofilozofik. Ja disa nga mendimet e tij filozofike të cilat plotësuan portretin e tij si poet në dhënien e çmimit Nobel.

• Duhet të jesh njeri, ta vësh vësh në vesh dhe ta kuptosh rëndësinë.

• Jemi të lumtur sepse ndjehemi dhe jo sepse jemi; jemi të madhërisht sepse reflektojmë për të shkuar drejt mirësisë.

• Dashuria është burim mirësie, por si gjithë gjërat që na rrethojnë në botën tonë, shkon dhe na mundon në largim; duhet kërkuar në lidhjet më gjëra të përjetshme. Por gjërat e përjetshme nuk janë për të gjithë, ashtu si bukuria dhe e vërteta; Zoti deshi që bukuria e cila është e përjetshme të bëhet e kapshme.

• As e shkuara dhe as e ardhmja, nuk na takon; por është masa e duhur, në kohën e tashme në ndjeshmërinë tonë, përse i përket kujtimit dhe keqardhjes, shpresës dhe frikës. Kështu, pra lumturia, nuk është veçse një kthim dhe një parashikim.

• Të gjithë të dashuruarit nuk janë poet, faleminderit Zot! Por ka një gjë që të gjithë të dashuruarit shohin me syrin e poetit, objektin e dashur.

• Për mua të duash ashtu si unë vetë e ndiej, është sakrificë për lumturinë e një gruaje ose të paktën t'i përkushtohesh.

• Të duash është diçka e përbashkët; të të duan është diçka më e rrallë. Dashuria është një ligj, dhe reciprokja në dashuri është rastësi.

• Ka njerëz të cilët më mirë i duam t'i shohim të sëmurë se sa të tradhtuar, dhe kjo quhet të duash.

• Në një dashuri të vërtetë, besimi është streha e xhelozisë.

• Gruaja është mishërimi i buzëqeshjes së Zotit.

• Miqësia të bën të duash jetën, dashuria i jep shije vdekjes.

• Të dashuruarit kërkojnë gjithmonë lumturinë, kurse miqtë e falin atë.

• Dashuria është një lutje në vazhdim; miqësia një shkëmbim i vazhdueshëm.

• Trupi për të jetuar, ka nevojë për të gjithë njerëzit; shpirti ka nevojë

për një publik; zemra është më pak kërkuese përse i përket numrit se sa cilësisë së marrëdhënieve të saj.

• Çfarë prisni nga një shoqëri ku të rinjtë pothuajse për një dekadë kanë veçse dashuri të tradhtuara apo të trishtuara?

• Shpirti duhet të dojë si puna e kripës: gjithmonë me karar.

• Të shohësh do të thotë të kesh, thotë poeti. I marrë kryekëput, përgjigjet njeriu pozitiv, atë që kam mund ta shes dhe përfitoj.

• Përse torturohemi të realizojmë ëndrrat për të ardhmen, përderisa nuk jemi të kënaqur me të tashmen që dikur ishte e ardhme.

• Bamirësia është më e lehtë për t'u dhënë se sa drejtësia.

• Udhëtimi: një lamtumirë që ecën.

• Poezia është frymëmarrja e zemrës së tejmbushur

• Poezia është gjithësia e hedhur në muzikë, falë zemrës.

• Poezia shpesh është arti i transformimit të mendimeve në fjalë.

• Jeta, vdekja; dhe gjumi hyjnor, lindin nga e njëjta puthje.

• Instinkti shtyn, ndërsa ndjenja morale tregon.

• Njeriu më i ditur nuk është ai që njeh më shumë të vërteta, por ai që njeh më të mirat.

• Të gjes të vërtetën do të thotë të konstatosh; por ta aplikosh është si ta krijosh. Ja përse filozofia na afron më pak drejt Zotit sesa virtyti.

• Në filozofi duhet që të reflektosh për një kohë të gjatë për të dhënë idenë e një mendimi naiv.

• Kur çështjet e zemrës nuk shpjegohen dot, njerëzit e ndjeshëm janë gjithmonë më inferiorë në diskutimet filozofike.

• Shpirti është i qetë kur zemra është e kënaqur, prandaj dhe gjithë besimet janë të mirëpritura, të vërteta apo të gënjeshtërt, por duhet një.

• Fatkeq, njeriu ndien nevojën e lutjeve përpara Zotit; i lumtur, ai nuk e ndien asnjëherë të nevojshme ta falënderojë.

• Fjalët zemër, shpirt dhe Zot janë kthyer në thelbësore për poezinë. /Gazeta “ExLibris”/

# Haki Stërmilli, shkrimtari që u bë ateist pas krimeve serbe ndaj shqiptarëve

Nga: Gëzim LLOJDIA

1.

Viti 1966. Shkrimtari Nasho Jorgaqi sjell një copëz jete nga shkrimtari Haki Stërmilli. Botuar në gazetën letrare "Drita", shkrimtari thotë: Kohët e fundit na kanë rënë në dorë disa dokumente të rëndësishme, ndërmjet tyre dhe autobiografia, që hedhin drite mbi jetën e shkrimtarit Haki Stërmilli. "Është rasti, që në përkujtim të 14 vjetorit të vdekjes, t'u kujtojmë lexuesve të tij të shumtë, disa fakte mjaft interesante që saktësojnë dhe zgjerojnë njohuritë tona mbi këtë autor të nderuar të letërsisë shqipe".

Haki Stërmilli lindi me 7 maj 1895 në një familje të varfër qytetare. "Im atë", shkruan shkrimtari në autobiografi, "nuk trashëgoi gja nga prindët e vet. Im amë kishte trashigë një sasi toke por kjo ishte shite ma vonë për nevoja të familjes... Familja erne... ishte në lagjen ma të vorfën të Dibrës, ku banojshin njerëz që me krah e sigurojshin bukën..".

Shkrimtari i ardhshëm u rrit në kondita të vështira, në një ambient besimtarësh dhe u edukua që për së vogli me një frymë fetare. Kjo gjë la gjurmët e saj tek ai, po vetë jeta e bëri shpejt ateist. Dhe, kjo ndodhi pas masakrave dhe padrejtësive që bënë shovinistët serbomedhenj, në kurriz të

popullsisë së krahinës së Dibrës. "Atëherë", shkruan ai, "ndiva në vetvete një revolution shpirtuer dhe u binda se nuk kishte drejtësi hyjnore. Qysh atëherë u bana ateist".

Mësimet Haki Stërmilli i bëri në vende të ndryshme; i filloi në vendlindje e pastaj në Selanik dhe i kreu në gimnazin e Manastirit. Qeveria e Ismail Qemalit i akordoi bursë për të ndjekur studimet e larta jashtë, por vdekja e të vëllait gjatë Luftës Ballkanike, e detyroi të rrijë pranë familjes. E, jo vetëm kaq, po sipas një zakoni të egër të kohës, ai duhej të martohej me të vejen e të vëllait. Megjithë kundërshtimin e vendosur, për disa vjet me radhë, Haki Stërmilli u detyrua t'i nënshtrohet këtij zakoni kur ishte ende 20 vjeç. Këtë ngjarje të rëndë ai nuk do ta harrojë dhe më vonë tërthorazi do ta shprehë në romanin "Sikur të isha djalë". Drama e Dijes është në fakt drama e vete autorit. Revolta dhe patosi i fortë i kësaj heroine të rebeluar ndaj ambientit fanatik të kohës, shpjegohen mjaft mirë dhe me disa motive personale të vetë shkrimtarit.

2.

Shkrimtari N. Jorgaqi sjell më vonë jetën politike të Haki Stërmillit. "Jetën politike, Haki Stërmilli", shkruan autori, "e ka filluar që shpejt. Qysh më 1907 ai mëson të këndojë shqip dhe propagandon idetë e rilindjes e mësimin e gjuhës amtare. Kur

vjen në Shqipëri, më 1913, vihet menjëherë në shërbim të shtetit shqiptar, duke marrë nëpunësi të ndryshme, i frymëzuar nga ideale patriotike. Këto ideale dhe përqafimi i ideve përparimtare të kohës e lidhin Haki Stërmillin me ato forca që luftonin kundër feudalizmit për interesat e popullit. Agjitacioni i Avni Rustemit -shkruan Hakiu - m'i pat hapë sytë dhe pat ba efekt në mue. Kjo shpjegon faktin pse Hakiu u shkëput shpejt nga influenca e ndonjë personaliteti negativ të kohës dhe pas vdekjes së A. Rustemit, në Kongresin e shoqërisë 'Bashkimi' (gusht 1924) u zgjodh sekretar i përgjithshëm i saj".

3.

Duke vijuar më tej me periudhën e emigracionit të shkrimtari H. Stërmilli, autori thotë: "Periudha e emigracionit (1924-1929) në jetën e shkrimtarit është e mbushur plot aktivitete politike. Ai endet, me detyra të caktuara, nëpër vende të ndryshme të Evropës, gjithnjë në luftë kundër fashizmit dhe regjimit të Zogut. Zgjidhet anëtar i Komitetit të Konares, që në themelimin e saj. Bashkëpunon me shtypin antizogist, bile dhe atë komunist, duke shkruar artikuj politikë si në gazetën 'Liria kombëtare' dhe 'Federasyon Ballkanik', organ që dilte në Vjenë, nën drejtimin e Gjergj Dimitrovit. Jeton rreth 14 muaj në Bashkimin Sovjetik. Zhvillon aktivitete antifashiste në Austri

e Itali. Përrashtohet nga këto vende dhe detyrohet të hyjë në Jugosllavi Atje autoritetet e arrestojnë e pastaj e internojnë në Mitrovicë. Për këtë periudhë, H. Stërmilli shënon në mes të tjerash: '...megjithë që nuk isha komunist dhe nuk kuptoja nga marksizëm-leninizmi, u përpoqa të formoj me njerëz përparimtarë celula komuniste në Dibër, në Strugë, e në Manastir".

4.

Periudha pas viteve 1920. Ja çfarë shkruan autori N. Jorgaqi: "Në mars të vitit 1929, ai arrestohet nga autoritetet jugosllave dhe, duke u trajtuar si një kriminel ordiner, i dorëzohet Zogut. Ky akt i qeverisë jugosllave ngjalli zemërim në qarqet përparimtare të kohës, nëpër vendet e ndryshme të Evropës. Personalitete të shquara, si Gjergj Dimitrovi, Anri Barbysi, Albert Ajshtajni etj., protestuan për këtë akt arbitrar të qeverisë jugosllave, që binte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe kërkuan nga sekretariati i Lidhjes së Kombeve sigurimin dhe shpëtimin e demokratit revolucionar shqiptar. Dhe, fakti që gjyqi politik i Zogut e dënoi Haki Stërmillin vetëm me pesë vjet burgim, shpjegohet dhe me ndikimin që ushtroi fushata për shpëtimin e tij në Evropë. Koha e burgut që për shkrimtarin një periudhë e rëndë. Zogu tregojë i pamëshirshëm ndaj armiqve të

tij, sidomos ndaj atyre që e kishin njohur nga afër dhe më vonë e kishin demaskuar si kish vepruar Haki Stërmilli. Lufta Nacional-Çlirimtare i hapi horizont patriotit të vjetër demokrat. Fill pas Konferencës së Pezës ai u radhit me Frontin Nacional Çlirimtar. Ai është nga intelektualët e parë që përqafoi pa hezitim vijën e drejtë të P.K.Sh. për një luftë të vendosur kundër fashizmit. Që në fillim, Haki Stërmilli kryeson një këshill Nacional-Çlirimtar të intelektualëve në Tiranë dhe propagandon ideat e luftës. Në verën e vitit 1943, ai hidhet në ilegalitet. Së pari në çetën e Sllavës, e pastaj në krahinën e Dibrës shkrimtari partizan vë në shërbim të Lëvizjes gjithë forcat e veta morale e intelektuale, duke qene gjithnjë i bindur në drejtësinë e vijës së partisë".

5.

Këto janë disa nga të dhënat e reja që hedhin drite në jetën e shkrimtarit tonë, thotë studiuesi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqi në artikullin kushtuar Haki Stërmillit në 14 vjetorin e vdekjes së shkrimtarit. "Ai vdiq në një moshë kur mund t'i jepte akoma letërsisë sonë. Po veprat e shumta që ka lënë në dorëshkrim dhe veçanërisht ditari i luftës: "Shtigjet e lirisë", dy romanet, njëri nga koha e Skënderbeut e tjetri kushtuar luftës së rinisë sonë antifashiste, janë një kontribut i çmuar i shkrimtarit, ndonëse të panjohura akoma nga masa e lexuesve". /Telegrafi



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Arbëria ndali Prishtinën, Drenica mposhti Besën

Drenica ka shijuar fitoren e parë në këtë kampionat, derisa Besa regjistron edhe humbjen e dytë në IPKO Superligë. Arbëria arriti ta ndalë në barazim Prishtinën, në ndeshjen e dytë të elitës

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 22 SHTATOR** - Skuadra e promovuar në Superligë, Arbëria, e ka ndalur Prishtinën në ndeshjen e dytë të edicionit 2020/2021, pasi të martën luajtën baras 1-1). Skuadra e drejtuar nga Arbnor Morina kaloi e para në epërsi në minutën e dhjetë. Ishte Dior Zaberxha ai që shënoi një gol të bukur për rezultatin 1-0. Kryeqytetasit e barazuan rezultatin në minutën e 35-të, kur Oto Johen realizoi për 1-1.

Në pjesën e dytë gola të tjerë nuk pati dhe skuadrat ndanë pikët, kurse pas dy xhirove të dyja këto skuadra kanë grumbulluar nga katër pikë. Në ndeshjen e zhvilluar në Skenderaj, Drenica nuk lejoi befasi në përballje me Besën, pasi shënoi fitore me përmbysje 2-1. Pejanët kaluan të parët në epërsi në minutën 34-t, me golin e realizuar nga Mattheus Da Paula. Hysen Tahiri në fund të pjesës së parë i barazoi shifrat në 1-1, kurse në pjesën e dytë Qemal Elshani e vulosi rezultatin final 2-1. Drenica në



dy ndeshje ka regjistruar një humbje dhe një fitore, kurse Besa në dy ndeshje ka regjistruar dy humbje. Sot (e mërkurë) zhvillohen dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro,

### IPKO SUPERLIGA

Arbëria - Prishtina 1-1  
Drenica - Besa 2-1

Sot takohen:

Llapi - Gjilani

Ballkani - Feronikeli

Drita-Trepça '89 (Është shtyre)

kurse derbi do të jetë në mes të Ballkanit dhe Feronikelit. Në stadiumin "Zahir Pajaziti", Llapi e pret Gjilanin që në ndeshjen e parë pësoi debakël nga "Nikli". Ndërsa ndeshja në mes Dritës dhe Trepçës '89 zhvillohet me vonë për shkak se kampionët e Kosovës në raundin e tretë parakualifikues të Ligës së Evropës do të përballen me Legian.

## Musolli paraqitet te Gjilani



**GJILAN, 22 SHTATOR** - Mesfushori Besa Musolli është paraqitur në skuadrën e Gjilanit. Në fakt, mesfushori me përvojë të madhe kishte arritur marrëveshje ditë më parë me klubin nga Anamorava, por pengesë ishte fletëlëshimi nga skuadra e Kukësit. Musolli luajti plot tetë vjet me skuadrën shqiptare. "Gjilani dhe futbollisti llapjan, Besar Musolli, kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi, ku mesfushori

do ta bartë fanellën e skuadrës kuq e bardh të Gjilanit. Për mesfushorin nga Podujeva, Gjilani është vetëm skuadra e dytë në karrierën e tij në futbollin vendor në Kosovë, pasi që më parë, para transferimit në Kukës, Musolli ishte paraqitur për skuadrën nga Merdarja, KF Hysi", thuhet në njoftimin e Gjilanit. Musolli pas tri viteve të kaluara në vendlindje te KF Hysi, në vitin 2012 transferohet te

skuadra nga Superiorja, me të cilën kaloi plot tetë vjet dhe gjatë kësaj kohe arriti të fitojë disa trofe nga kampionati elitar në Shqipëri. Performancat fantastike të futbollistit të ri të Gjilanit do të shpërbleheshin në vitin 2017, ku Musolli do të fitojë edhe nga Përfaqësuesja A e Kosovës, në takimin për kualifikimet për kampionat botëror kundër Ukrainës, ku edhe debutoi me fanellën e Kosovës.

## FC Feronikeli bën homazhe pranë shtatores së Fehmi dhe Xhevë Lladrovci

**DRENAS, 22 SHTATOR** - FC Feronikeli në mënyrë të organizuar ka bërë homazhe pranë shtatores së Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, duke i nderuar në përvjetorin e tyre të 22-të. Vepra e dëshmorëve të rënë për liri nuk duhet harruar asnjëherë

dhe duhet nderuar e përkujtuar gjithmonë, së pari si krenari e pastaj si obligim ndaj atyre që na sollën lirinë. Në pamundësi të ardhjes në Kosovë, veprën e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci e ka përkujtuar edhe presidenti i klubit, Naser Ramaj. "Heronjtë

tillë si Fehmi e Xhevë Lladrovci janë ata që flijuan jetën për liri dhe meritojnë çdo respekt nga ne. Janë të rënë ata që ndërtaun themelet e Kosovës së lirë. Lavdi për Fehmi e Xhevë Lladrovcin dhe për të gjithë heronjtë e luftës!", ka thënë Ramaj.



## Të gjithë negativë në testin për Covid në Klubin e Dritës

**GJILANI, 22 SHTATOR** - Klubi i futbollit Drita ka njoftuar se i gjithë stafi ka rezultuar negativ në testin për Covid-19 pak para ndeshjes me Legia Varshavën në

kualifikimet për Ligën e Evropës. "Të gjithë negativë në testet e Covid-19. Klubi ynë Drita është testuar për testet e Covid-19 në prag të ndeshjes me Legian që

do të zhvillohet në Poloni. Sapo morëm lajmin e mirë se të gjithë të testuarit kanë rezultuar negativë. Sfidat me Covid-19 është fituar dhe tani fokusohemi tërë-

sisht për ndeshjen", thuhet në njoftimin e Dritës. Ndeshja zhvillohet të enjten në Poloni, në kuadër të rrethit të tretë kualifikues.



## Liverpooli dhe Reali në garë për Mbappen

Paris, 22 shtator - Sulmuesi i Francës dhe PSG-së, Kylian Mbappe, me shumë mundësi do të largohet verën e vitit të ardhshëm nga klubi francez. Sipas prestigjiozes franceze "L'Equipe", Liverpooli po e mbikëqyr

situatën e sulmuesit e të njëjtën gjë po bën edhe Real Madridi. Trajneri Jurgen Klopp më parë ka pranuar se do të ishte jashtëzakonisht e vështirë të arrihej një marrëveshje për sulmuesin.

Siç raportohet nga "Daily Mail", Liverpooli kontaktoi me përfaqësuesin e Mbappesë në verën e vitit 2017, kur "ylli" i atëhershëm i Monacos po përgatitej ta bënte lëvizjen e tij të parë të madhe në skenën evropiane.

Liverpooli pagoi 65 milionë sterlina për Thiago Alacantaran dhe Diogo Jotan javën e kaluar, por një shpenzim tjetër i madh për Mbappen do të ishte në kundërshtim me strategjinë e klubit mbi transferimet.



## Anduena Rifati: Pa basketboll nuk mund të jetojë

PRISHTINË, 22 SHTATOR - Një nga basketbollistët më të dalluar në basketbollin femëror në Kosovë ishte Anduena Rifati. Ajo ishte basketbolliste e dalluar e Bashkimit dhe mbrojti edhe ngjyrat e Kosovës. Anduena fitoi disa herë titullin dhe Kupën në Kosovë, si dhe u zgjodh MVP, kurse katër herë është zgjedhur sportiste e vitit në Prizren, si dhe ka marrë çmimin e karrierës.

*Si vendose të luaje basketboll?*

**Rifati:** Unë jam rritur në një familje të frymëzuar nga sporti. Babai im (i ndjerë) Tajar Rifati ka qenë basketbollist, një ndër gjyqtarët e parë të ish-Jugosllavisë dhe komisar i FBK-së. Nëna ime Hidajete Rifati ka qenë basketbolliste dhe ka marrë pjesë në Ligat Krahinore të ish-Jugosllavisë. Po ashtu, motra dhe vëllai kanë kontribuar në basketboll. Kështu që kjo më ka inspiruar që edhe unë t'i bashkëngjitem këtij sporti.

*Cila ka qenë idhulli yt në fëmijëri?*

**Rifati:** Idhulli im në basketboll në fëmijëri ka qenë Drazhen Petroviq.

*Cila ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?*

**Rifati:** Trofeu më i rëndësishëm dhe më i ëmbël ka qenë i vitit 1997 (para luftës), ku pas mëvetësimit të basketbollit kosovar në atë kohë u shpallëm kampionë, duke mundur



Universitetin e Prishtinës në prani të 1 000 shikuesve në terren të hapur në Prizren.

*Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?*

**Rifati:** Ndeshjen që nuk mund të harroj ka qenë finalja e Kupës së Kosovës në Suharekë (viti 2007) kundër Sigal Prishtinës, ku me pikët e mia erdhëm deri te Kupa. Ishte ndeshje e paharruar. Më kujtohet momenti kur mbeten vetëm 17 sekonda dhe mua nuk m'u dridh dora dhe shënova në kundërsulm për t'i dhuruar Kupën skuadrës time, ku edhe në atë kohë në media u shpalla heroinë e klubit. Ndeshja përfundoi me rezultat 75:73.

*Cila ka qenë kundërshtarja më e vështirë që je ballafaquar?*

**Rifati:** Për kundërshtarë më të vështirë s'mund të apostrofoj dikë, pasi konkurrenca ka qenë shumë më e fortë se tash. Shumica e lojtarëve kanë qenë defensive të mira.

*Sa të mungojnë basketbolla dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?*

**Rifati:** Çdo sportistit i mungon sporti kur pensionohet, por unë çdoherë jam afër basketbollit, duke i përcjell thujtë të gjitha ligat duke filluar nga Euroliga, Aba Liga, si dhe Superligën e Kosovës, në veçanti nga afër përcjelli çdo ndeshje të Ponte Prizrenit (si vendas), pasi trajner është vëllai im. Vitet e fundit kam marrë pjesë në turne të basketbollit të organizuara nga Komiteti Olimpik i Kosovës si përfaqësuese e Bankës TEB ku punoj.

*Cili është mesazhi për lojtaret e reja që duan të merren me basketboll?*

**Rifati:** Mesazhi për basketbollistët është që të merren sa më shumë me sport, të fokusohen në punë dhe vetëm punë, sepse puna është çelës i suksesit dhe asnjëherë mos të dëshpërohen apo dorëzohen. Nëse të gjitha nuk bëhen basketbolliste, dikush bëhet trajner, gjyqtarë, mbajtës e statistikës apo çka tjetër që e mban në hap dhe afër me basketbollin.

## Alonso: Nuk rikthehem për 'show', por për të fituar

MADRID, 22 SHTATOR - Në vitin 2021 Fernando Alonso do të rikthehet në pistat e Formulës 1. Piloti spanjoll, dy herë kampion bote në Formula 1, do të garojë me Renault, që sezonin tjetër do ta ketë emrin Alpine F1 Team. Alonso do ta zërë vendin e Daniel Ricciardo, ndërkohë që për spanjollin kjo është hera e tretë që ulet në ulësen e makinës franceze. Alonso ka qenë në fabrikën ku prodhohet njëvëndëshja franceze, ku ka nisur nga puna me inxhinierët për makinën që do ta pilotojë vitin tjetër. Spanjollin do të ketë si



shok skuadre francezin Esteban Ocon. I veshur me uniformën e makinës së re, Alonso dukej në formë dhe gati për t'u rikthyer në pistë pas dy vjetësh pushim.

"Jam gati ta ndihmoj skuadrën për të qenë sa më kompetitive në pistë. Nuk rikthehem për 'show', por për të fituar", ka thënë Alonso.

### SHKURT

#### Balaj: Qeveria të kthejë më shumë sytë nga futbolla

Bojkotimi i futbollit në vendin tonë është një çështje që ka prekur edhe futbollistët e kombëtares sonë. Sulmuesi Bekim Balaj i ka bërë thirrje qeverisë që t'i hedhë më shumë sytë nga futbolla, në një deklaratë të publikuar nga Liga Profesioniste në rrjetet sociale. "Futbollin e kemi krenari kombëtare. Tani më shumë se kurrë duhet t'i gjendemi pranë. I bëjmë thirrje qeverisë që t'i hedhë më shumë sytë nga futbolla", ka thënë Balaj. Deri më tani Liga Profesioniste dhe qeveria nuk kanë gjetur gjuhën e përbashkët për katër kërkesat, të cilat klubet e Superiores duan që të realizohen.

#### Neymari rrezikon të mos luajë deri në vitin 2021

Ylli i PSG-së, Neymar, rrezikon të dënohet me plot 8-10 ndeshje pezullim nga Komisioni i Disiplinës së Ligës Franceze. Sipas "El Partidazo de COPE" klubi i Marseilles disponon pamje të një rasti ku braziliani ofendon rëndë në bazë racore futbollistin japonez Hiroki Sakai. Në rast se kjo gjë vërtetohet, atëherë Neymar rrezikon të mos luajë deri në fillim të vitit 2021. Organet përkatëse janë duke u marrë me këtë pretendim të klubit të Marsejës, teksa në ditët në vijim pritet të vijë edhe vendimi përfundimtar. Në rregullore është e përcaktuar qartë që ofendimet në bazë racore dënohen nga 8 deri në 10 ndeshje.

#### Vidali prezantohet te Interi

Arturo Vidal edhe zyrtarisht është lojtari i Interit, duke u ribashkuar sërish me trajnerin Antonio Conte. Mesfushori ka firmosur për dy vite me zikaltrit dhe në kontratë është opsioni për të rinovuar dhe për një vit tjetër. Të martën Interi e ka konfirmuar transferimin e kilianit. Katalanasit kërkonin 1 milion euro për shërbimet e tij, por marrëveshja u mbyll vetëm me bonuset. 33-vjeçari ka punuar me Conten te Juventusit, ku arriti ta fitonte tre herë radhazi Serie A. Më pas Vidali e vazhdoi karrierën në Bundesligë me Bayern Munchen, për t'u transferua më pas tek Barcelona në vitin 2018.

#### PSG-ja parakalon Cityn në garë për Koulibaly

PSG-ja ka parakaluar Manchester Cityn në garën për Kalidou Koulibaly. Napoli do të përfitojë plot 75 milionë sterlina (81,7 milionë euro) për kartonin e mbrojtësit. Sipas "The Telegraph", marrëveshja është shumë afër, me ofertën e parisienëve që tejkalon kufirin minimal prej 80 milionësh të vendosur nga presidenti De Laurentis. Lajmi që vjen nga Mbretëria e Bashkuar është në antitezë me atë që u deklarua në "Radio Kiss Kiss Napoli" nga ish-menaxheri i futbollit franko-senegalez, Bruno Sain: "Kalidou në Napoli është mirë dhe për sa kohë që është në Napoli ai do të luajë dhe do të japë më të mirën e tij. Nuk besoj në zërat për kalimin e tij te PSG. Klubi francez tashmë ka shumë mbrojtës në skuadër dhe nuk ka burime financiare. Nuk mendoj se ata mund të shpenzojnë më shumë se 30 milionë për një operacion të tillë".

#### Gjyqtari italian dhe dashura e tij vriten me thikë

Gjyqtari i Serisë B dhe Serisë C, Daniele De Santis, është vrasur së bashku me partneren në banesën e vet në Lecce. Sipas "La Repubblica", 33-vjeçari dhe dashura e tij 30-vjeçare, Eleonora Manta, janë gjetur të therur për vdekje. Miqtë e kanë parë një mashkull duke ikur nga vendi i ngjarjes me thikë në dorë, mirëpo nuk kanë arritur ta identifikojnë. De Santis ka qenë fillimisht gjyqtar në nivelet e Serisë C, ndërsa gjatë karrierës së tij ka ndarë drejtësinë në 130 ndeshje zyrtare. Në vitin 2017, ai debutoi në Serinë B si gjyqtar i katërt në ndeshjen Pisa-Benevento.



Në pajtim me nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Paneli për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutiv të Bordit të BQK-së, publikon:

### Shpallje

Për plotësimin e një (1) pozite të anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

#### Profili i kërkuar:

- Person me integritet dhe përgatitje universitare;
- Minimum dhjetë (10) vite përvojë profesionale ose akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitet apo çështje juridike;
- Njohuri në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të rëndësishme të lidhura me misionin, objektivat dhe detyrat e BQK-së;
- Në mënyrë specifike të plotësojnë kushtet sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve tjera paraqet përparësi.

Emërimi do të jetë për një mandat pesëvjeçar duke filluar nga data e emërimit.

Lista e kandidatëve që kualifikohen nga ana e Panelit do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili do të përzgjedh nga një individ për secilën pozitë. Miratimi dhe emërimi për këto pozita do të bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 84 paragrafi 27, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-209 për BQK-ën.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë një CV me detaje dhe një letër motivuese përmes email adresës vijuese: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ose në dorë në zarf të mbyllur në arkivin e BQK-së, Rruga Garibaldi nr. 33 në Prishtinë, ose përmes postës në adresë të BQK-së: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (shënim: për pozitën e anëtarit joekzekutiv të Bordit të BQK-së), Rruga Garibaldi nr. 33,1000 Prishtinë, Kosovë.

Afati i fundit për aplikim është 8 tetor 2020, në orën 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit do të thirren për intervistë.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada - Government

**Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit**  
**Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine**  
**Ministry of Economy and Environment**

### Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë për Kushtet Ndërtimore

**“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.**

Nr. prot: 3517/20 të datës 30.07.2020, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

**Posta rekomandë:**  
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit  
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit  
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë  
Ndërtesa e Rilindjes  
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:  
<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:  
Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor  
[Suzana.goranci@rks-gov.net](mailto:Suzana.goranci@rks-gov.net)  
Telefon: + 381 38 200 32 553



U skladu sa članom 38. Zakona br. 03/L-209 o Centralnoj banci Republike Kosovo (CBK), Panel za izbor neizvršnih članova Odbora CBK-a, objavljuje:

### Oglas

Za popunjavanje jednog (1) položaja neizvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosovo

#### Zatraženi profil:

- Osoba sa integritetom i univerzitetskom spremom;
- Najmanje deset (10) godina profesionalnog ili akademskog iskustva u oblastima ekonomije, finansija, bankarstva, računovodstva ili pravnih poslova;
- Znanje u stvaranju i praćenju sprovođenja važnih politika povezanih sa misijom, ciljevima i zadacima CBK-a;
- Specifično da ispunji uslove iz člana 40. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u;
- Znanje engleskog i drugih jezika je prednost.

Imenovanje će biti za mandat od pet godina počevši od datuma imenovanja.

Spisak kandidata kvalifikovanih od strane Panela biće poslat Skupštini Republike Kosovo, koja će odabrati po jednog pojedinca za svaki položaj. Odobrenje i imenovanje za ove položaje izvršiće predsednik Republike Kosovo u skladu sa članom 84. stav 27. Ustava Republike Kosovo i članom 38. stav 2. Zakona br. 03/L-209 o CBK-u.

Zainteresovani kandidati treba da dostavljaju CV sa detaljima i motivacionim pismom na sledeću e-mail adresu: [paneli@bqk-kos.org](mailto:paneli@bqk-kos.org) ili ručno u zatvorenoj koverti u arhivi CBK-a, ulica Garibaldi br. 33 u Prištini, ili poštom na adresu CBK-a: Centralna banka Republike Kosovo (napomena: za mesto položaj neizvršnog člana odbora CBK-a), Ulica Garibaldi br. 33,1000 Priština, Kosovo.

Krajnji rok za podnošenje prijave je 8. oktobar 2020. u 16:00 časova.

Na intervju će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kooperativa Bujqësore “Victoria”, Rahoveci, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 810011974, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa Kooperativa Bujqësore “Victoria”, Rahovec, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810011974, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Kooperativa Bujqësore “Victoria”, Rahovec has come to the decision to quit its nr. 810011974, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Komuna e Gjakovës  
Opština Gjakovica Gjakova Municipality  
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.  
GJAKOVË  
Nr.: 302  
Data: 22.09.2020



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.  
GJAKOVË

KE: 0390/320 010  
E-mail: nplstgj@gmail.com  
Info: 0390/324 268  
Web:

Nr. Biznesit: 71228673  
Nr. Fiskal: 601568233  
Nr. TVSH: 330311853  
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 nenit 5, dhe nenit 6 pika 5,1 dhe pika 6 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Regullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënieën në Punë të Punëtorëve dhe neni 15 pika 20 të Rregullores nr.121 të dt. 04.04.2016 për Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësive të Stafit Punues, dhe vendimit nr. 299 të datës 21.09.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, rishpallë këtë:

## KONKURS

**Pozita: Kopshtar - Pastrues**

**Numri i pozitave: 1 (një)**

**Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi**

### Detyrat dhe përgjegjësit:

- Mirëmbanë dhe bënë çdo ditë pastrimin e nevojshëm të të gjitha hapsirave jashta dhe brenda ndërtesës që disponon Ndërmarrja;
- Ujit dhe mirëmban të gjitha hapësirat e gjelbëruara të cilat gjenden brenda dhe përreth objektit të Ndërmarrjes;
- Pastron dhe mirëmban oborrin, peronët dhe hapësirat e shfrytëzuara nga operatorët;
- Mbanë pastërtinë dhe përkujdeset për të gjitha pajisjet që të jenë në vendin e duhur, brenda dhe jashta objektit;
- Përkujdesje të veçant mbanë rreth mirëmbajtjes dhe zhvillimit të gjelbrimit në të gjitha hapsirat e Ndërmarrjes.
- Kryen punë dhe detyra të tjera të caktuara nga Shefi i Stacionit dhe KE.

### Kushtet për pjesëmarrje : Kualifikimi dhe Aftësitë:

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm ose fillorë.
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë punë përkatëse

### Dokumentacioni i kërkuar:

- Diploma mbi shkollimin.
- Dëshmi mbi përvojën e punës.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetim, jo më të vjetër se 3 muaj;

### Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.

-Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

### Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.

Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 14:00. Konkursi është i hapur nga data 23.09.2020 – 07.10.2020.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

**Vërejtje:** Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta hudhen poshtë.

Gjakovë, më 22.09.2020

Kryeshefi Ekzekutiv – Flamur Bicurri

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, "Spitali i Përgjithshëm" - Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për trajtimin-sterilizimin e mbeturinave medicinale në Ferizaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.09.2020 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Bifurkacioni" Ferizaj do të organizohet debat publik nga "Spitali i Përgjithshëm" - Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin për trajtimin-sterilizimin e mbeturinave medicinale në Ferizaj.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM  
<https://us04web.zoom.us/j/8845868583?pwd=ZDluOWhBalhIMzltL2ZsZ3VpUDRqdz09>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

► Shpëtim Haliti shpall të pavlefshme dëftesën e klasës –I deri –VIII- të shkollës fillore "Dëshmorët e Qyqavicës" në Qirez.

► Islam Nitaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës, të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë.

► Ajet Laçi shpall të pavlefshme dokumentet e firmës "Auto Taxi Ajet Laçi" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905

RC COLA  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1905  
0.5L